



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCËVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E AUDITIMIT



Nr. 16068/4 Prot.

Tiranë, më 12.11/2019

Lënda: Dërgohet Raporti Përfundimtar i Auditimit

Drejtuar: Z. Lorenc CALA

Drejtor

Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapsinor

Rruga « Papa Gjonpali II « Godina nr.3 Kati II

Tiranë.

Në përfundim të auditimit të kryer në Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapsinor, ju dërgojmë raportin përfundimtar të auditimit.

Mirëpresim opinionin tuaj, lidhur me punën tonë duke plotësuar formularin e vlerësimit, i cili do të na shërbente për të vlerësuar performancën tonë dhe për të identifikuar fushat ku duhet të përmirësohemi për të qenë të dobishëm për ju dhe të tjerët.

Me respekt,

ILIR MEÇE

DREJTOR



RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT

- Objekti i auditimit:** Auditimi i sistemeve, përputhshmërisë dhe financiar
- Subjekti i audituar:** Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapsinor
- Subjekti auditues:** Drejtoria e Auditimit të Brendshëm e Ministrisë së Financave

Përmbledhje ekzekutive

Në zbatim të Ligjit nr. 114, datë 06.11.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, akmarrvëshjes së përbashkët nr. 15428/1 datë 22.11.2016 dhe planit të auditimit nr. 16068/1 datë 25.09.2019, është kryer një mision auditimi në Autoritetin Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor, për auditimin e sistemit, përputhshmërisë dhe financiar (ASIG).

ASIG është, është një institucion publik qëndror, në varësi të Këshillit të Ministrave dhe financohet nga Buxheti i Shtetit.

Misioni kryesor i saj është krijimi i infrastrukturës kombëtare të të dhënave gjeohapësinore në Republikën e Shqipërisë, organizimin dhe funksionimin e autoriteteve kombëtare të informacionit gjeohapësinor; përcaktimin e kushteve të përgjithshme që lidhen me mbledhjen, krijimin, përpunimin, përditësimin, ndërveprimin, aksesin, ruajtjen, përdorimin dhe arkivimin e informacionit gjeohapësinor; detyrimet dhe kompetencat e autoriteteve publike për krijimin, sigurinë, aksesin dhe përdorimin e informacionit gjeohapësinor.

Në përfundim të misionit ka rezultuar se :

Struktura e ASIG nuk është plotësuar, ka akoma 5 vënde vakante.

Nuk ka funksionuar Bordi i Informacionit Gjeohapsinor (BIG), nga 30.06.2017, e në vazhdim pasi kryetar i këtij bordi sipas përcaktimit në ligjë nr. 72/2012, « Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapsinor në RSH », është Ministri i linjës. (Ministria e Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike). Kjo ministri me riorganizimin e Këshillit të Ministrave, nga viti 2017 është shkrire, për pasoj vartësia e ASIG ka kaluar në Këshillin e Ministrave.

Nga auditimi rezulton se ASIG në mënyrë të përsëritur i është drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave nga i cili kanë vartësin për zgjidhjen e këtij problemi. Mosfunksionimi i BIG është bërë pengesë në mbarvajtjen e punës së ASIG, pasi ka ndikuar në mosrealizimin e objektivave të këtij Autoriteti.

Nuk janë paraqitur për miratim në Këshillin e Ministrave, 16 standarte kombëtare gjeohapësinore të përgatitura pasi sipas përcaktimeve të nenit 11 të ligjit nr. 72/2012, «Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapsinor në RSH » ato duhet të kenë miratimin paraprak të BIG.

Shpenzimet Korente për periudhën viti 2017, janë realizuar në shumën 51.319.505 lekë, nga 75.900.000 lekë të planit vjetor pra më pakë nga plani përfundimtar për 24.580.495 lekë, ose në masën 68 %, sipas artikujve rezulton si më poshtë:

Shpenzimet Korente për periudhën viti 2018, janë realizuar në shumën 44.677.344 lekë, nga 55.400.000 lekë të planit vjetor pra më pakë nga plani përfundimtar për 10.722.656 lekë, ose në masën 81 %.

Shpenzimet Korente për periudhën viti Janar-Gusht 2019, janë realizuar në shumën 30.998.824 lekë, nga 64.489.000 lekë të planit vjetor pra më pakë nga plani përfundimtar për 33.998.824 lekë, ose në masën 48 %.

Hyrje.

Në këtë Raport janë paraqitur gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e grupit të auditimit pas përfundimit të misionit auditues të kryer në ASIG. Fushat e auditimit sipas parashikimit në Planin e auditimit janë: auditimi i sistemit të kontrollit të brendshëm, i përputhshmërisë dhe financiar.

Auditimi është zhvilluar në përputhje me legjislacionin, manualët e procedurave si dhe standartet ndërkombëtare të pranuar në fushën e auditimit të brendshëm të sektorit publik.

Ky auditim u krye në përputhje me kuadrin ligjor të mëposhtëm:

Ligjin nr. 72/2012, «Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapsinor në RSH», dhe akteve nënligjore në zbatim të tij .

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 144 datë 22.02.2012, «Për miratimin e dokumentit të politikave “Për krijimin e infrastrukturës kombëtare të të dhënave gjeohapësinore”.

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 147, datë 20.2.2013, “Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e autoritetit shtetëror për informacionin gjeohapësinor” etj.

Rezulton se me me Vendimin nr. 28 datë 16.06.2015, është miratuar Kodi i Etikës për Autoritetin Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor.

Rregullore për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike në Autoritetin Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor, etj.

Auditimi i planifikuar ka filluar me datë 30.09.2019 sipas njoftimit nr. 16068, datë 20.09.2019 dhe është planifikuar të vazhdojë deri më datën 18.10.2019.

Në përfundim të punës në terren, u krye takimi i mbylljes në subjektin ku u diskutuan konkluzionet e auditimit, të cilat janë trajtuar gjerësisht në raportin paraprak të auditimit, i cili i është dërguar ASIG me shkresën nr. 16068/2, datë 05.11.2019. ASIG me shkresën 16068/3, datë 11.11.2019, ka konfirmuar këtë raport me observacionin bashkëlidhur të cilin grupi i auditimit e trajton në këtë raport përfundimtar të auditimit.

Termat e auditimit.

Termat e auditimit janë parashikuar në Planin e auditimit nr. 16068/1, datë 25.09.2019, si mision i planifikuar bazuar në aktmarrëveshjen e përbashkët nr. 15428/1 datë 22.11.2016.

Auditimi për veprimtarinë e ASIG, iu nënshtrua periudhës nga 1 Janar 2017 deri më 31 Gusht 2019. Auditimi u realizua në terren gjatë periudhës 30.09.2019-18.10.2019. Për zhvillimin e procesit është autorizuar grupi i punës i përbërë nga Latif Çela dhe Flori Alla.

Metodat e përdorura.

Grupi i auditimit ka përdorur metoda dhe teknika auditimi në varësi të fushës së audituar. Ndërsa për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm është përdorur metoda e modelimit të pyetsoreve dhe intervistimit.

Gjetjet e auditimit.

Në vijim janë renditur gjetjet e auditimit në fushën e veprimtarisë së ASIG, për periudhën e audituar.

1. Auditimi i sistemit të kontrollit të brendshëm.

-Mjedisi i kontrollit të brendshëm

Objektivi i Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor është krijimi i infrastrukturës kombëtare të të dhënave gjeohapësinore në Republikën e Shqipërisë; organizimi dhe funksionimi i autoriteteve kombëtare të informacionit gjeohapësinor; përcaktimin e kushteve të përgjithshme që lidhen me mbledhjen, krijimin, përpunimin, përditësimin, ndërveprimin, aksesin, ruajtjen, përdorimin dhe arkivimin e informacionit gjeohapësinor; detyrimet dhe kompetencat e autoriteteve publike për krijimin, sigurinë, aksesin dhe përdorimin e informacionit gjeohapësinor, fushë e cila rregullohet me Ligjin nr. 72/2012 dhe aktet e tjera nënligjore. Për realizimin e këtij objekti është krijuar ky institucion në varësi të Këshillit të Ministrave.

- Përsa i përket integritetit personal dhe etikës profesionale të punonjësve, rezulton se stafi i ASIG ndjek kërkesat e legjislacionit shqiptar për politikën e integritetit dhe të etikës, Kodin e Etikës, të miratuar me ligjin nr. 9131 datë 08.09.2003. “Rregulla të Etikës në Administratën Publike”. Bazuar sa më sipër, njësia ka të miratuara rregullat e etikës për stafin e saj të përfshira këto në Kodin e Etikës së ASIG, të miratuar me urdhrin nr. 28 datë 16.06.2015 “Për miratimin e Kodit të Etikës së ASIG”. Sipas këtij kodi punonjësit zbatojnë rregullat e etikës duke vepruar në mënyrë të pavarur nga pikëpamjet politike, personale, etj.

-Institucioni ka të miratuar për çdo vit deklaratën e misionit në përputhje me kërkesat e ligjit për MFK.

-Për sa i përket strukturës organizative, garantimi i ndarjes së detyrave, hierarkisë etj, rezultoi se;

Struktura e ASIG është krijuar në përputhje me funksionet e përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore. Struktura e saj është miratuar për herë të parë në vitin 2013 dhe ka ndryshuar disa herë deri në momentin e auditimit dhe sa vijon:

Për periudhën objekt auditimi ASIG, ka funksionuar sipas strukturës referuar Urdhrit të Kryeministrit nr. 60, datë 5.04.2016 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor”, të ndryshuar, struktura e ASIG në Janar të vitit 2017 është miratuar me 51 punonjës..

Me Urdhrin e Kryeministrit nr. 49, datë 12.04.2017 “Për disa ndryshime në Urdhrin nr. 60, datë 5.04.2016, të Kryeministrit “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor”, numri i punonjësve të ASIG reduktohet 49 veta.

➤ Në vitin 2017 ASIG rezulton me 11 pozicione vakante.

Gjatë procedurave të rekrutimit, zhvilluar nga Departamenti i Administratës Publike, gjatë vitit 2017, janë emëruar punonjësit si më poshtë:

- Eugerta Teqja / Specialist në Sektorin e Koordinimit;

- Mikel Millja / Përgjegjës i Sektorit të Standardeve për Gjeoinformacionin (me ngritje në detyrë);
- Denisa Kukaj / Specialiste në Sektorin e Standardeve për Gjeoinformacionin.

Pozicionet e tjera të publikuara nga DAP, janë mbyllur pa fitues.

- Në janar të vitit 2018, në ASIG rezultoi 9 pozicione vakante.

Si pasojë e faktit që institucioni ishte në proces të ndryshimeve strukturore, në 6-mujorin e parë të vitit 2018 nuk u publikuan pozicione vakante.

Me Urdhrin e Kryeministrit nr, 121, datë 31.07.2019 "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor", numri i punonjësve të ASIG është miratuar për 46 punonjës.

Nga auditimi rezulton se pas ndryshimeve strukturore, ka vijuar procesi i publikimit të vendeve vakante nga DAP.

Në përfundim të këtij procesi janë emëruar punonjësit si më poshtë:

- Arian Lasku / Përgjegjës i Sektorit të Sistemeve CORS;
- Saimir Burba / Përgjegjës i Sektorit të Hartografisë (me ngritje në detyrë);
- Brunilda Tafa / Specialist në Sektorin e Hartografisë(me ngritje në detyrë);
- Gjatë vitit 2019 derinë muajin shtator, në ASIG rezultojnë 10 pozicione vakante, nga të cilat;
 - 5 pozicione të mbetura nga viti 2017;
 - 3 pozicione të krijuara pas largimit me dorëheqje të punonjësve;
 - 2 pozicione të krijuara pas lëvizjes me ngritje në detyrë.

Me procedurat e rekrutimit, zhvilluar nga Departamenti i Administratës Publike, gjatë vitit 2019, janë emëruar punonjësit si më poshtë:

- Xhesian Balili / Specialist Sektori i GIS-it Kombëtar (student ekselence);
- Bledar Sina / Përgjegjës i Sektorit të Sistemeve CORS;
- Eriona Shabani / Përgjegjëse në Sektorin e Gjeoportalit Kombëtar;
- Irista Shahini / Specialist në Sektorin Remote Sensing;
- Enis Karanxha / Specialist në Sektorin Remote Sensing;

Aktualisht në ASIG janë 5 pozicione vakante. Në drejtorinë e Gjeodezisë dhe Hartografisë 3 vende vakante. Konkretisht Specialist /Sektori i KRGJSH, Specialist/ Sektori i Hartografisë dhe Specialist /Sektori i Remote Sensing. Gjithashtu janë pa plotësuar edhe 2 pozicione në Drejtorinë e GIS-it dhe Gjeoportalit si specialist /Sektori i Gjeoportalit Kombëtar dhe Specialist /Sektori i Standardeve për gjeoinformacionin.

Aktualisht ASIG funksionon me strukturën si më poshtë.

Drejtor i përgjithshëm 1

- **Drejtoria e gjeodezisë dhe hartografisë (20veta)**

- Drejtor 1

- sektori kornizës referuese gjeodezike (1 përgjegjës + 3specialista)
- sektori i hartografisë dhe përpunimit të të dhënave gjeohapësinore (1 përgj. + 5 specialista)
- sektori i Infrastrukturës së Sistemit CORS (1 përgj. + 2 specialista)

Sektori i Remote Sensing(1 përgj. + 5 specialistë)

• **Drejtoria e GIS dhe gjeoportalit hapsinor (15 veta)**

Drejtor 1

- setori i GIS kombëtarë (1 përgjegjës + 3specialista)
- sektori i sigurisë dhe gjeoportalit (1 përgjegjës + 3 specialistë)
- sektori i koordinimit dhe EU standartet (1 përgjegjës + 2 specialistë)
- sektori standarteve për gjoinformacionin (1 përgjegjës + 2 specialistë)

Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse (10 punonjës)

Drejtor 1

- Sektori i financës (1 përgjegjës + 3 specialistë)
- Sektori i shërbimeve mbështetëse (1 përgjegjës + 4 specialistë)

Struktura aktuale e ASIG i përshtatet karakterit të aktivitetit të saj dhe është në gjëndje ti japë informacionin e nevojshëm titullarit për marrjen e vendimeve të menaxhimit.

Praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore;

Procedurat e rekrutimi të punonjësve për periudhën e audituar janë bërë sipas kërkesave të ligjit “Për shërbimin Civil”, procedurat e emërimit/apo largimit të stafit, si dhe niveli i pagës së tyre janë të rregulluara me këtë ligj dhe ky proces kryhet nga DAP. Gjatë periudhës nën auditim struktura nuk ka qenë e plotësuar me staf në të gjitha pozicionet. Aktualisht sipas strukturës të miratuar së fundmi në vitin 2017, janë të plotësuara 41 pozicione dhe janë vakante 5 pozicione të tjera në proces rekrutimi.

Nga ana e ASIG është përgatitur një draft për ndryshimin e ligjit, me qëllim harmonizimin e tij me aktet e tjera ligjore dhe nënligjore, dhe është paraqitur Ministrit të Inovacionit me shkresën nr. 306/2 datë 12.01.2017. Rezulton se ndryshimet në ligj nuk janë bërë akoma, por vetë njësia është në pritje të ndryshimeve.

Nga auditimi u konstatua se për periudhën objekt auditimi ka patur lëvizje të stafit (largim me dorëheqje një në vitin 2019, 3 punonjës, dhe ngritje në detyrë, 2 punonjës. Rezulton se për pozicionet e pa plotësuara me staf puna është mbuluar nga stafi ekzistues, nën mbikqyrjen e Drejtorit të Përgjithshëm dhe drejtorëve të drejtorive, nga të cilët është bërë dhe shpërndarja e punës. Proceset e punës të mbetura vakant janë realizuar nga stafi ekzistues, të cilët janë autorizuar për kryerjen e tyre në mënyre verbale nga drejtuesi, por nuk ka procedura të shkruara për zëvendësimin e stafit.

-Përshkrimet e proceseve të punës janë të hartuara për çdo punonjës sipas sektorit përkatës. Gjithashtu me ndryshimin e strukturës kanë ndryshuar dhe përshkrimet e punës për secilin pozicion. U bë verifikimi i tyre dhe rezultoi se ato ishin të firmosura nga punonjësit përkatës i emëruar, nga eprori direkt. Formularët e përshkrimeve të punës janë hartuar në përputhje me formatin standart të miratuar (për nëpunësit civilë) dhe në përputhje me punën që kryen secili pozicion, duke përfshirë dhe objektivat, qëllimi i punës, përgjegjësitë, etj.

-Aftësitë profesionale të punonjësve, ishin në përputhje kërkesat e vendosura për pozicionet e punës. Kriteret e punës për secilin pozicion ishin në përputhje me kriteret e përcaktuara në aktet ligjore në fuqi “Për shërbimin civil” (VKM-së 262 datë 25.03.2015) dhe me kriteret e veçanta që kanë të bëjnë me specifikën e punës së institucionit. Staf i ishte i punësuar në përputhje me kriteret e vendosura për punësimin, si diplomimi, vjetërsia në punë etj. Nuk u konstatuan parregullsi.

Ndryshimet në strukturë që janë bërë pothuajse në çdo vit, rezulton se janë pasqyruar dhe në përshkrimet punës duke hartuar përshkrime të reja për çdo pozicion të ri apo të ndryshuar.

Për sa i përket vlerësimeve mbi performancën e punës së stafit, rezultoi se ato janë bërë nga eprorët direkt çdo 6- mujor, në përputhje me aktet në fuqi për shërbimin civil. Për periudhat viti 2017,2018 dhe 6 mujorin e viti 2019, rezultoi se janë plotësuar dhe janë depozituar në dosjet personale të punonjësve vlerësimet e punës së tyre. Ato ishin të konfirmuara nga specialisti përkatës, eprori direkt dhe nga kundërfirmuesi, në përputhje me aktet në fuqi. Edhe për punonjësit e punësuar rishtazi, vlerësimet janë kryer për periudhën që ata kanë ushtruar funksionin. Nuk ka sistem për motivimin e stafit. Sa më lart nuk u konstatuan parregullsi.

Në lidhje me trajnimin e stafit gjatë periudhës nën auditim, rezulton se punonjësit e ASIG janë trajnuar nga ASPA për tema të ndryshme si prokurimin publik, për etikën, hartimin dhe menaxhimin e politikave publike etj. Gjithashtu stafi ka kryer dhe trajnime nga BE, trajnime për sistemin IT, trajnime për autoCAD, etj.

Gjithashtu trajnime janë kryer dhe në kuadër të projektit të përbashkët të financuar nga BE.

Dhe për vitin në vazhdim njësia ka planifikuar nevojat për trajnimin e stafit.

Për sa i përket dosjeve të personelit rezultoi se ato ishin të plotësuar me dokumentacionin e duhur. Secila dosje ishte e inventarizuar (fletën e inventarit) si dhe fletën prezantuese të dosjes teknike të nëpunësit në përputhje me kërkesat e vkm nr. 117 datë 05.03.2014.

Menaxhimi i riskut.

Menaxhimi i riskut të institucionit është i rëndësishëm për arritjen e objektivave të ASIG, si dhe për përcaktimin e përgjegjësive të përshtatshme ndaj këtyre risqeve. Në lidhje me miratimin e strategjisë së riskut, rezulton se institucioni ka të hartuar dhe të miratuar strategjinë e riskut për vitet 2017 - 2020, strategji e cila përditësohet në varësi të ndryshimeve të riskut (mund të lindin risqe të reja ose të zbuten ato ekzistueset).

Istitucioni bën një analizë e risqeve të identifikuar gjatë vitit dhe impaktin që ato kanë në objektivat e institucionit, sidomos ato me risk të lartë të cilat menaxhohen dhe monitorohen në vazhdimësi. Të gjitha risqet monitorohen në mënyrë që të shmangin ngjarje jo të favorshme dhe në këtë kuadër për monitorimin janë caktuar dhe përgjegjësit ose zotëruesit e riskut sipas drejtorive. Gjithashtu institucioni ka të hartuar rregjistrin e riskut për secilin vit, në të cilin janë përfshirë risqet më të rëndësishme që kanë lidhje me realizimin e objektivave të njësisë si dhe niveli i rëndësisë së tyre. Bazuar në këtë rregjistër institucioni ka hartuar dhe plan veprimi për ta menaxhuar riskun gjatë vitit kalendarik. Në këtë plan janë të caktuar dhe personat përgjegjës si dhe kordinatori për menaxhimin e tij. Risqet janë të kategorizuara për secilën drejtori dhe raportohen rregullisht tek titullari.

Aktiviteti i kontrollit.

-Në lidhje me procedurat dhe autoritetin për delegimin, transferimin dhe regjistrimin e autorizimit standart dhe të rasteve të veçanta, rezulton se ASIG, ka të përshkruara të gjitha proceset e punës, hallkat e vendimmarrjes dhe kontrollet e brendshme të vendosura.

Në ndarjen e detyrave, rezulton se çdo drejtori/sector i ka të ndara qartë funksionet dhe nuk u konstatua mbivendosje, (psh; autorizimi, ekzekutimit dhe regjistrimi i transaksioneve financiare, kryhen nga punonjës të ndryshëm). Edhe proceset e kërkesës për pagesë dhe kryerja e saj, kryen nga persona të ndryshëm. Edhe për drejtoritë/sectorët e tjerë ka një ndarje të qartë të detyrave. Nuk u konstatuan raste të ushtrimit nga i njëjti punonjës i funksioneve të pa pajtueshme, të cilat rrezikojnë kryerjen e detyrave me objektivitet e paanshmëri. Janë të përcaktuara dhe funksionojnë linjat e përgjegjshmërisë dhe të raportimit.

Përsa i përket sistemit të nënshkrimeve, rezulton se të gjitha angazhimet financiare miratohen në të njëjtën kohë si nga NA ashtu dhe NZ dhe nuk u konstatuan parregullsi.

Në lidhje me zbatimin e procedurave për kontabilizimin e plotë, të saktë, të rregullt dhe në kohë të të gjitha transaksioneve, rezulton ato janë kryher bazuar në aktet ligjore në fuqi si udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", etj. Procedurat e raportimit, mbikëqyrjes, vlerësimit të efikasitetit dhe të efektivitetit të veprimtarive të institucionit janë kryer në përputhje me rregullat në fuqi.

Menaxhimi i burimeve njerëzore kryhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi si dhe rregullat për menaxhimin e burimeve njerëzore të miratuara nga DAP. Nuk u konstatuan parregullsi;

Gjatë auditimit, rezultoi se nga njësia e audituar ishin respektuar rregullat në fuqi për dokumentimin e të gjitha transaksioneve dhe të veprimtarive që lidhen me mbarëvajtjen e institucionit;

Për sa i përket garantimit e ruajtjes së informacionit dhe të aktiveve të njësisë (ruajtja e dokumentacionit), rezulton se ky proces kryhet në bashkëpunim me zyrën e protokollit, në përputhje me rregullat në fuqi, për përcaktimin e niveleve të fshehtësisë së informacionit dhe kofidencialitetin.

Njësia gjatë zhvillimit të veprimtarisë së saj, të gjitha proceset e punës i dokumenton zyrtarisht ose nëpërmjet sistemit të IT, për vetë natyrën specifike që ka gjeodezia, dokumentimi i të gjitha proceseve të punës, transaksioneve, hartave etj, këto procedura ose gjurmët e tyre janë pasqyrar edhe në rregulloret të funksionimit të ASIG. Si e tillë sigurohet gjurma e duhur e auditimit për vijueshmërinë dhe monitorimin e veprimtarisë së institucionit, njësia vetë ka hartuar dhe miratuar gjurmën e auditimit.

Për sa i përket procedurave të verifikimit, rezulton se institucioni i ka zbatuar procedurat e vlerësimit, kontrollit dhe monitorimit të sistemit, proceset e punës kontrollohen/mbikëqyren në nivel hierarkik, ku përgjegjësi i sektorit është në rolin e kontrolluesit, më pas procedura kalon tek drejtori i drejtorisë i cili e konfirmon atë dhe më pas procedura kalon tek drejtori i përgjithshëm i cili miraton/aprovon atë.

Në lidhje me sistemin e IT, (Gjeoportalin) ASIG, ka të ndërtuar rregulla dhe një sistem të përshtatshëm kontrolli. Gjithashtu ASIG, ka marrë përsipër që të përballojë me stafin e saj dhe shërbimimin e mirëmbajtjes së këtij sistemi.

Informimi dhe komunikimi.

Informimi dhe komunikimi është një proces thelbësorë për zbatimin e gjithë objektivave të kontrollit të brendshëm. Nga auditimi rezulton se komunikimi realizohet në rrugë zyrtare dhe në formë shkresore por për problematika të veçanta dhe vetë specifikën e institucionit komunikimi bëhet dhe në mënyrë elektronike ose gjatë takimit midis palëve.

-Në lidhje me identifikimi, mbledhja dhe përhapjen e një informacioni të vërtetë dhe të besueshëm në një format të përshtatshëm, brenda afateve të duhura, duke bërë të mundur që çdo punonjës të marrë përsipër përgjegjësitë përkatëse, rezulton se struktura e ASIG ka të përcaktuara qartë funksionet dhe detyrat, që të garantojnë se informacioni merret i plotë, i saktë, në kohë, si dhe nga kush merret, si përpunohet dhe se si komunikohet në instancat përkatëse.

-Struktura ka të ngritur një komunikim si vertikal, ashtu edhe horizontal, në të gjitha nivelet e hierarkisë së njësisë, si dhe ka të ndërtuar një sistem të përshtatshëm të informacionit për menaxhimin e njësisë që ka si qëllim shpërndarjen e udhëzimeve dhe urdhrave të qartë dhe të saktë për rolet e çdo punonjësi.

Informimi dhe komunikimi përmbushen dhe me procesin e raportimit periodik, në të cilin përfshihen raportimet të drejtorët e drejtorive dhe që i drejtohen rregullisht drejtuesit të institucionit, i cili më pas e raporton sipas nivelit hierarkik.

Për sa më lart rezulton se procedurat e informimit dhe komunikimit garantojnë sigurinë që informacioni merret nga të gjitha burimet, duke përfshirë edhe burime të brendshme dhe të jashtme, sigurinë që proceset janë krijuar për t'ia komunikuar informacionin e nevojshëm të gjithë stafit.

Sa më lart rezulton se është i ndërtuar një mekanizëm për marrjen e informacioneve të dobishme si nga jashtë (institucionet bashkëpunuese) ashtu dhe brenda drejtorive apo sektorëve.

Monitorimi.

Në lidhje me ngritjen e një sistemi për monitorimin e menaxhimit financiar dhe të kontrollit rezultoi se sistemet e kontrollit të brendshëm janë ngritur me qëllim vlerësimin e sistemit të cilësisë së performancës në kohë. Sistemi i monitorimit të kontrollit të brendshëm kryhet nëpërmjet monitorimit në vazhdimësi dhe vlerësimeve të shkëputura. Në lidhje me sa më sipër drejtuesi i institucionit ka vendosur rregull që secili specialist të bëjë raportimin javor për aktivitetet e kryera (për punën që ka kryer) si tek eprori direkt ashtu dhe drejtori i përgjithshëm, rregull i cili pamvarësisht se zbatohet, duhet të jetë i shkruar dhe miratuar, (të përfshihet në manualin e proceseve të punës).

Monitorimi mbi realizimin e objektivave bëhet rregullisht nga stafi i ngarkuar duke analizuar dhe shkaqet për rastet e mosrealizimit.

Duke ju referuar zbatimit të ligjit nr. 10296 “Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin” të ndryshuar, njësia ka bërë vetëvlerësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm për secilin vit objekt auditimi, dokument të cilin së bashku me deklaratën e raportit vjetor të cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm e ka dërguar zyrtarisht në ministrinë e Financave.

Për sa më lart rezulton se procesi i monitorimit është nën kontroll të vazhdueshëm nga drejtuesi i njësisë.

a) Auditimi i përputhshmërisë

Zbatimi i akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi që rregullojnë veprimtarinë e institucionit të Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor.

Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor funksionon konformë kërkesavë të përcaktuara në ligjin nr. 72/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor në RSH”. Në këtë ligj është përcaktuar se ASIG, ka për mision:

Ngritjen e kornizës referuse gjeodezike shqiptare sipas standardeve europiane për të mundësuar mbështetjen e një harte unike për të gjithë territorin e RSH, ngritjen e infrastrukturës kombëtare të të dhënave gjeohapësinore në RSH, nëpërmjet gjeoportalit, përpilimin dhe zhvillimin e standardeve në fushën e gjeoinformacionit si dhe implementimi i tyre nëpër institucione, qofshin ato prodhues apo përditësues të gjeoinformacionit.

Për realizimin e këtij misioni ASIG kryen disa funksione si, bashkërendimin dhe mbështetjen e veprimtarisë së drejtorive, harmonizimin e kuadrit ligjor, përcaktimin e rregullave të përgjithshme bazë të veprimtarisë së saj, etj.

Në pikën 1 të nenit 13 të ligjit është përcaktuar se “Autoritetet publike përgjegjëse për krijimin ose mbajtjen e të dhënave gjeohapësinore, të parashikuara në nenin 2 të këtij ligji, në

bashkëpunim me ASIG-un, krijojnë, mbledhin dhe përditësojnë metadat për këto të dhëna, në përputhje me këtë ligj dhe me rregullat e përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit”.

Në zbatim të kësaj pike Këshilli i Ministrave ka miratuar këto procedura me vendimin nr. 696 datë 16.08.2013, dy vjet pas miratimit të ligjit.

Përsa i perket daljes së akteve nënligjore e përcaktuar kjo në nenin 27 të ligjit “Aktet nënligjore”, rezulton se nga ana e ASIG janë miratuar aktet nënligjore sipas nënpikave të përcaktuara në këtë nen dhe nene të tjera të këtij ligji. Për periudhën objekt auditimi ne kuadër të plotësimit të akteve nënligjore nga ASIG janë miratuar aktet si më poshtë:

1. VKM nr. 142 datë 22.02.2017 " Për Miratimin e Dokumentit “Standardet Shtetërore për Specifikimet Teknike të Informacionit Gjeohapësinor në Shqipëri - Tema: Emërtimet Gjeografike” .

2. VKM nr. 133, datë 20.03.2019, “Për miratimin e dokumentit "Standardet shtetërore për specifikimet teknike të informacionit Gjeohapësinor në Shqipëri -Tema: Rrjetet e transportit".

3. VKM nr. 134, datë 20.03.2019, “Për miratimin e dokumentit "Standardet shtetërore për specifikimet teknike të informacionit Gjeohapësinor në Shqipëri Tema: Gjeologjia".

4. VKM nr. 359, datë 29.05.2019, “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM-në nr.669, datë 7.8.2013 "Për Miratimin e Rregullave për Përcaktimin, Krijimin dhe Realizimin e Kornizës Referuese Gjeodezike Shqiptare (KRGJSH), si Metadatë”” e ndryshuar me VKM-në nr. 322, datë 27.04.2016 .

5. VKM nr. 397, datë 19.06.2019, “Për miratimin e dokumentit "Standardet shtetërore për specifikimet teknike të informacionit Gjeohapësinor në Shqipëri - Tema: Ortoimazheria".

6. VVKM nr. 398, datë 19.06.2019, “Për miratimin e dokumentit "Standardet shtetërore për specifikimet teknike të informacionit Gjeohapësinor në Shqipëri -Tema: Modeli dixhital i terrenit".

7. VKM nr. 399, datë 19.06.2019, “Për rregullat për shkëmbimin e grupeve dhe të shërbimeve të të dhënave gjeohapësinore mes autoriteteve publike".

8. VKM nr. 451 datë 3.7.2019, "Për rregullat uniforme të infrastrukturës së informacionit gjeohapësinor".

Veprimtaria e këtij institucioni është ushtruar dhe mbështetur nga tre drejtoritë e saj, ku më poshtë po trajtojmë veprimtarin e tyre në kuadër të relizimit të objektivave për periudhën objekt auditimi.

b) Vlerësime mbi veprimtarinë e drejtorisë së GIS-it Kombëtarë dhe Gjeoportalit.

Ndërtimi i strukturës së ASIG është i bazuar ne ligjin nr. 72/2012 “Për organizimin dhe funksionimin infrastrukturës kombëtare të të dhënave gjeohapësinore në Republikën e Shqiperisë”. Drejtorja e GIS-it Kombëtarë dhe Gjeoportalit është një ndër hallkat kryesore në krijimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor, për krijimin e aksesit për palët e interesuara dhe përdorimin e këtij informacioni prej tyre. Funksionimi me strukturë të plotë i kësaj drejtorie ka filluar gjatë vitit 2016, e cila në strukturën aktuale të ASIG është e përbërë nga katër sektorë me 15 punonjës. Misioni i kësaj drejtorie është krijimi, administrimi dhe mirmbajtja e GIS-it kombëtar dhe gjeoportalit. Në këtë kuadër sipas përcaktimit të ligjit kjo drejtori është përgjegjëse për krijimin e akteve ligjore dhe standarteve

shtetërore për krijimin, përditësimin, shkëmbimin, aksesin dhe përdorimin e informacionit gjeohapësinor, në përputhje me standartet europiane. Puna për krijimin e gjeoportalit ka filluar nga viti 2014 dhe fillimisht janë publikuar të dhënat e para pjesore të gjeoportalit të aksesueshme nga përdoruesit.

- Për periudhën objekt auditimi ASIG ka marrë vendimet për përcaktimin autoritetit publik përgjegjës për 21 tema të nenit 11 të ligjit 72/2012, duke përmbyllur kështu procesin e vendimmarrjes të parashikuar nga neni 12 i këtij ligji. Nga kjo drejtori janë zhvilluar inspektime në 5 autoritete publike përgjegjëse dhe janë hartuar raportet mbi ecurinë e projekteve në fushën e gjeoinformacionit.
- Nga kjo drejtori është realizuar hartimi dhe miratimi me VKM i dokumenteve, "Për Miratimin e Rregullave të Ndëveprueshmërisë të të Dhënave, Grupeve të të Dhënave dhe Shërbimeve Gjeohapësinore", dhe dokumentit "Standardet Shtetërore për Specifikimet Teknike të Infrastrukturës së Informacionit Gjeohapësinor në Shqipëri-Tema Emërtimet Gjeografike". Gjithashtu në zbatim të kërkesave të ligjit sipas parashikimeve të bëra në biznes-planin 2015-2020, mbështetur në direktivën INSPIRE të Bashkimit European 2007//EC, ASIG, deri në momentin e auditimit nga 35 standarte ka miratuar me VKM, 10, ka përgatitur për miratim 16, dhe ka në proces hartimi 9 standarte që duhet ti përmbyll brenda vitit 2020. Siç kemi trajtuar më lart mosmiratimi i këtyre standarteve ka të bëjë me mosfunksionimin e BIG.
- Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se është realizuar zhvillimi i sistemit të Gjeoportalit Kombëtar dhe është bërë marrja në dorëzim e tij, bashkë me sistemet e tjera ËebGis të autoritete publike a) Monumentet e Kulturës (<http://imk.gov.al>); b) Sistemi ËebGis i AKEP (<http://broadband.akep.al/akepi/atlas>).
- Për këtë sistem është hartuar dhe miratuar rregullorja përkatëse për funksionimin e tij.
- Është realizuar shtimi i kapaciteve HË në ASIG, Hardëare-ve Server dhe Storage në suport të Gjeoportalit Kombëtar, ka përmirësuar infrastrukturën ekzistuese është arritur: a) Gjenerimi i raporteve javore për Gjeoportalin Kombëtar; b) Mirëmbajtja e Ëebsite ASIG nga ana e stafit të ASIG.
- ASIG ka bërë publikimin e 12 grupeve të dhënave gjeohapësinore si Ortofoto RGB 2015-2017, Ortofoto CIR 2015-2017, Model Dixhital Terreni 2007-2008, Emërtime Gjeografike etj. Është bërë i mundur konvertimi dhe publikimi në Gjeoportalin Kombëtar i të gjitha shtresave të gjeoinformacionit në sistemin koordinativ KRGJSH në zbatim të VKM-së nr. 669, datë 07.08.2013 "Për Miratimin e Rregullave për Përcaktimin, Krijimin dhe Realizimin e Kornizës Referuese Gjeodezike Shqiptare (KRGJSH), si Metadatë. (Ndryshuar me VKM Nr. 322, datë 27.04.2016)". Nga ASIG janë plotësuar dhe publikuar metadatat për të gjitha shtresat e gjeoinformacionit të publikuara në Gjeoportalin Kombëtar në zbatim të VKM-së nr. 1077, datë 23.12.2015, Për Miratimin e Rregullores "Për Krijimin, Ruajtjen dhe Përditësimin e Metadatave, Strukturën e Katalogimit dhe Afatet e Krijimit të Matadatave Specifike për çdo Temë". Është hartuar dokumentacioni i specifikimeve teknike për projektin "Projektimi i GIS-it Kombëtar" dhe gjatë gjashtë-mujorit të dytë është zhvilluar dhe përmbyllur procedura e prokurimit nga ana e ASIG.

Më tej procedura e prokurimit u bllokua në fazën e shpalljes së fituesit nga Agjencia e Prokurimit Publik në zbatim të VKM-së nr. 673 datë 22.11.2017.

- ASIG ka mbyllur me sukses e projektin e bashkëpunimit me Autoritetin e Hartografisë dhe Kadastrës “Statens Kartverk” të Norvegjisë, në lidhje me krijimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë. Ka bashkëpunuar me Agjencinë e Kadastrës dhe Hartografisë së Holandës në projektin rajonal “Informacioni Gjeohapësinor në Ballkanin Perëndimor”.

Për periudhën objekt auditimi është realizua rmonitorimi i sistemit të Gjeoportalit Kombëtar dhe raportimi i “case” për çdo problematikë të vërejtur, është përmirësuar infrastruktura dhe pajisjeve TIK, të Gjeoportalit Kombëtar, Është Siguruar ndërveprimi i Gjeoportalit Kombëtar me sisteme të tjera ËebGIS, janë publikuar në Gjeoportalin Kombëtar të dhënat dhe shërbimeve gjeohapësinore, për: Të dhënat e modelit 3-dimensional të terrenit 2015-2017 „Planet Urbanistike në nivel Kombëtar, Sektorial dhe Vendor, Hartat historike italiane, Hartat historike të AQTN për qytetet: Tiranë, Durrës, Kavajë, Rrogozhinë, Shijak, Krujë, Vorë, Shkodër, Lezhë, Laç , shkalla 1:500, dhe të dhënat gjeohapësinore sipas standardit të miratuar, për temën: “Emërtime Gjeografike. Janë korrigjuar dhe përditësuar metadatat për të dhënat dhe shërbimet gjeohapësinore të publikuara në Gjeoportalin Kombëtar etj. është përditësuar dokumenti mbi analizën e sigurisë së sistemit, masat e sigurisë, bazuar në udhëzimin e ALCIRT-it dhe janë plotësuar kërkesat specifike sipas ligjit nr. 10325, datë 23.09.2010, “Për Bazat e të Dhënave Shtetërore”, është siguruar vijimi i ndërveprimit të sistemit të Gjeoportalit Kombëtar, nëpërmjet shërbimeve të rrjetit, me sistemet ËebGIS të Planifikimit të Territorit, Monumenteve të Kulturës, Mbetjeve Urbane dhe ALBSREP. Po punohet për ndëveprimin me sistemin ËebGIS të AKEP-it, pasi të standardizohen të dhënat e këtij sistemi. Problematika kryesore e punës për Drejtorinë e GIS-it Kombëtar dhe Gjeoportalit ngelet mosfunksionimi i Bordit për Informacionin Gjeohapësinor BIG. Mosfunksionimi i Bordit për Informacionin Gjeohapësinor (BIG), ndër të tjera ka penguar paraqitjen për miratim, në Këshillin e Ministrave, të standardeve të gjeoinformacionit, për temat e nenit 11, të ligjit nr. 72/2012, pasi ligji parashikon miratimin e tyre paraprak nga BIG. Nga sektorët përkatës në ASIG janë përgatitur 16 standarde që presin miratimin nga BIG, përpara se të përcillen për miratim në Këshillin e Ministrave.

Për samë lart arrijmë në konkluzionin se Drejtoria e GIS-it Kombëtarë dhe Gjeopolit ka kryer veprimtarinë e saj në përputhje me ligjin dhe aktet e tjera që rregullojnë veprimtarinë e saj. Mos miratimi standardeve lidhet me faktin e mosfunksionimit të BIG.

c. Vlerësime mbi veprimtarinë e drejtorisë së Gjeodezisë dhe Hartografisë.

Drejtorja e Gjeodezisë dhe Hartografisë është pjesë e strukturës ASIG e përbërë nga 4 sektor dhe 20 punonjës. Detyrat dhe funksioni i kësaj drejtorie janë të përcaktuara në ligjin nr. 72/2012 dhe në VKM nr 147 dt. 20.02.2012 “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor” dhe kanë të bëjnë me identifikimin dhe koordinimin ndërinstytucional, me administrimin e informacionit gjeohapësinor, përcaktimin e standardeve dhe rregullave uniforme, në grumbullimin informacionit dhe përdorimin e tij

nga përdorues të ndryshëm. Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG) në përmbushje të objektivave ka për periudhën Janar 2017 – Gusht 2019 ka punuar për Ndërtimin dhe funksionimi i Infrastrukturës Kombëtare të Gjeoinformacionit - NSDI, (Bashkërendimi ndërinstytucional.). Ndërtimin dhe funksionimi, mirëmbajtja dhe përditësimi i Kornizës Referuese Gjeodezike Shqiptare (KRGJSH), si garanci për informacion gjeohapësinor të saktë dhe bazuar në standardet evropiane.

Ndërtimi i sistemit të të dhënave gjeohapësinore për zhvillimin e rajoneve nëpërmjet fillimit të krijimit të hartës bazë të RSH. Ka ndjekur me përkushtim të madh implementimin e projektit për krijimin e hartës dixhitale për 300 km², (zona Tiranë- Durrës) për të cilin aktualisht po punohet për konkretizimn e hartës model (Pilot) dhe modelim të produktit etj.

Ka bashkëpunuar me ekspert të huaj për “Asistencë për krijimin e Kornizës Referuese Gjeodezike në Shqipëri” (IPA_TAIEX Program_BE). Ka menaxhuar dhe implementuar projektin e përbashkët për ndërtimin e “Rrjeteve Gjeodezike”, për rajonin tonë (Shqipëri, Kosovë, Mali i Zi, Maqedoni), në kuadër të asistencës së Qeverisë Norvegjeze në lidhje me fushën e përcaktimit të Gjeoidit. Ka ndjekur në vazhdimësi Projektin IMPULS (Projekt i SIDA), me të cilin koordinatori i jonë, në mënyrë permanente ka raportuar dhe informuar të gjithë pjesmoresit për realizimin në kohë të axhentes se saj (2014-2020) në bashkëpunim me stafin Suedez. Ka realizuar pjesmarjen në aktivite në kuader të ketij dhe axhendës së miratuar nga Komiteti Drejtues i Projektit për sa i përket detyrimeve që ka ASIG. Në këtë kuadër ka organizuar një sërë aktivitetesh ndërkombëtare (Ëorkshop) me temë "Metadata dhe cilësia e të dhënave. Aktualisht po bashkëpunohet me JICA Projekt Team (JPT), për për hartimin e standarteve dhe manualeve të prodhimit të hartës dixhitale të shkallës 1:2000 në Republikën e Shqipërisë.(300 km²)

Nga grupi i auditit konstatohet se në kuadër të përmbushjes së objektivave ASIG duhet të mbështete me fonde për implemnetimin e direktivës INSPIRE të KE si dhe për implementimin e projekteve për krijimin e hartes bazë të unifikuar për të gjitha autoritetet që e perdorin atë, si dhe projekti i fotografimit ajror të bregut detar të shqiperisë si më prioritar në veprimtarinë e ASIG.

Për sa është trajtuar me sipër rezulton se drejtoria e Gjeodezisë dhe Hartografisë ka kryer veprimtarinë e saj në përputhje me ligjin dhe aktet e tjera që rregullojnë veprimtarinë dhe nuk u kostatuan parregullsi.

Mbi funksionimin e Bordit për Informacionin Gjeohapësinor - BIG

Bordi i informacionit Gjeohapsinor është ngritur bazuar në nenin 10 të Ligjit të ligjit nr. 72/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor në RSH”, si organ këshillimor i ASIG dhe Këshilli të Ministrave, për zhvillimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor.

Në zbatim të nënit 10 pika 2 e ligjit, është miratuar urdhërin e kryeministrit nr. 87 datë 25.07.2013 “Për përberjen, organizimin dhe funksionimin e bordit për informacionin gjeohapësinor (BIG)”, i ndryshuar, në të cilin janë përcaktuar që bordi përbëhet prej 18 vetash duke u kryesuar nga Ministria e Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, ndërsa anëtarët e tjerë janë drejtues të institucioneve të ndryshme. Në këtë urdhër janë përcaktuar dhe fusha e veprimtarisë së Bordit. Në përputhje me VKM nr. 147 datë 20.02.2013 “Për miratimin e rregullores “për organizimin dhe funksionimin e autoritetit shtetëror për informacionin gjeohapësinor”, neni 12, struktura përgjegjëse ASIG- ushtron

gjithashtu dhe detyrat e sekretariatit teknik të bordit të informacionit gjeohapësinor, veprimet e të cilat janë përcaktuar në nenin 13 të kësaj rregulloreje.

Gjithashtu në zbatim të urdhrin sa më lart, është hartuar dhe rregullorja e brendëshme për organizimin dhe funksionimin e bordit të informacionit Gjeohapësinor. Në këtë rregullore është caktuar se BIG mbledhet si rregull jo më pak se 4 herë në vit dhe mbledhja zhvillohet kur janë të pranishëm 2/3 e anëtarëve.

Nga verifikimi i praktikave të menaxhimit të mbledhjeve të bordit rezultoi se për çdo mbledhje janë të dokumentuara propozimi për bledhje drejtuar ministrit të inovacionit, nga drejtori i përgjithshëm; njoftimi për mbledhje drejtuar anëtarëve të bordit pas miratimit nga ministri, lista e pjesëmarrësve ku secili kishte konfirmuar pjesëmarrjen, procesverbalin e mbledhjes etj. Dokumentacioni për çdo mbledhje ishte në dosje të veçantë dhe i inventarizuar. Për vitin 2017 bordi është mbledhur 2 herë, dhe që nga 6-mujori i dytë 2017 e në vazhdim nuk ka funksionuar për mungesë të kryetarit të bordit.

Për sa trajtuar më sipër arrijmë në konkluzionin se njësisia ka një sistem të kontrollit të brendshëm që funksionon mirë, proceset të cilat zbatohen janë të shkruara dhe miratuar në rregulloren e funksionimit të ASIG.

Sipas rregullores së brendshme *"Për organizimin dhe funksionimin e Bordit për Informacionin Gjeohapësinor"* pjesë e Urdhrin Nr. 87, datë 25.7.2013 *"Për përbërjen, organizimin dhe funksionimin e Bordit për Informacionin Gjeohapësinor"*, i ndryshuar me Urdhrin nr. 235 datë 3.12.2013, neni 3 pika 4, *"Mbledhjet e BIG-ut thirren dhe drejtohen nga kryetari i BIG-ut, dhe në mungesë të tij, nga një prej anëtarëve të autorizuar prej tij"*.

Pas miratimit të përbërjes së Këshillit të Ministrave dhe shfuqizimit të VKM-së nr. 943, datë 9.10.2013, Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike është suprimuar, e për rrjedhojë BIG ka ngelur pa kryetar. Në mungesë të kryetarit apo një të autorizuar prej tij, Bordi për Informacionin Gjeohapësinor BIG nuk ka funksionuar. Menjëherë pas strukturimit të qeverisë, me shkresën nr. 467 datë 20.11.2017, drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave, ASIG ka kërkuar ndryshimin e akteve që rregullojnë veprimtarinë e ASIG, për varësinë dhe funksionimin e institucionit, duke përfshirë edhe Urdhrin nr. Nr. 87, datë 25.7.2013 *"Për përbërjen, organizimin dhe funksionimin e Bordit për Informacionin Gjeohapësinor"* i ndryshuar. Me shkresën nr.82, datë 15.02.2018, drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave, është përcjellë zyrtarisht paketa e akteve për ndryshimin e pikës 2 të Urdhrin nr. Nr. 87, datë 25.7.2013, që lidhet me kryesimin e tij. Pas shqetësimeve të shprehura, pranë kabinetit të Kryeministrit, nga Drejtori i Përgjithshëm i ASIG, në bashkëpunim me Departamentin për Zhvillim dhe Mirëqeverisje në Kryeministri janë përgatitur projektaktet për urdhrin e ri të BIG, të cilat janë përcjellë Sekretarit të Përgjithshëm në Maj 2019. Duke qenë se edhe pas këtij hapi nuk u bë e mundur dalja e urdhrin për funksionimin e BIG me shkresën nr. 254 datë 4.07.2019, projektaktet i'u përcollën zyrtarisht Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave. Nga Departamenti Rregullator dhe i Përputhshmërisë në Kryeministri, është konfirmuar se projektaktet duhet të paraqiten si propozim i Zëvendëskryeministrit, draftet përgatitura i janë përcjellë, nga Drejtori i Përgjithshëm me e-mail datë 23.09.2019, kabinetit të Zëvendës kryeministrit. Mosfunksionimi i Bordit për Informacionin Gjeohapësinor (BIG), ndër të tjera i ka pamundësuar ASIG paraqitjen për miratim, në Këshillin e Ministrave, të standardeve të gjeoinformacionit, për

temat e nenit 11, të ligjit nr. 72/2012, pasi ligji parashikon miratimin e tyre paraprak nga BIG. Nga sektorët përkatës në ASIG janë përgatitur 16 standarde që presin miratimin nga BIG, përpara se të përcillen për miratim në Këshillin e Ministrave. Për periudhën 2017-2019 janë zhvilluar dy mbledhje të Bordit për Informacionin Gjeohapësinor (gjashtë mujori i parë i Vitit 2017) respektivisht në 9.3.2017 dhe 24.05.2017, dosjet e të cilave disponohen nga Sektori i Kordinimit në rolin e sekretariat teknik të BIG. Për sa më sipër grupi i auditit Arrin në konkluzionin se mosfunksionimi i BIG për një periudhë të gjatë është bër pengesë për realizimin e objektivave të ASIG.

Në observacionin e paraqitur nga ASIG, është argumentuar me dokumenta se nga kjo agjensi janë ndërmar iniciativat e duhura ligjore me qëllim funksionimin e BIG. Janë përgatitur dhe dërguar për miratim ndryshimet ligjore të cilat presin miratim nga KM, vendime këto që do të zgjidhin këtë problem. Për sa sbaruam më sipër grupi i auditit arrin në konkluzionin se nga ASIG janë marrë masat e nevojshme prandaj rekomandimi i dhën në raportin paraprak rezulton i zbatuar brenda afatit të njohjes me raportin paraprak prandaj ai nuk lihet në këtë raport përfundimtar.

Auditimi financiar.

a) Zbatimi i rregullave mbi hartimin, miratimin dhe zbatimin e buxhetit.

Hartimi i programit buxhetor afatmesëm, është hartuar buxheti afatmesëm konformë ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”. Me shkresën nr.17954/2, datë 09.10.2018, e Ministrisë Financave dhe Ekonomisë, drejtuar ASIG, “Dërgohet analiza e kërkesave buxhetore në zbatim të Udhëzimit nr.7/2, datë 09.07.2018 “Për përgatitjen e PBA-së 2019-2021”. Me Vendimin e Keshillit të Ministrave nr.731, datë 12.12.2018 “Për miratimin e dokumentimit te programit buxhetor afatmesëm, rishikuar 2019-2021”, janë miratuar dokumentat e PBA-së, të rishikuar për periudhën 2019-2021.Me shkresën e Ministrisë Financave dhe Ekonomisë, nr.471, datë 14.01.2019, drejtuar Autoritetit Shtetëror të Informacionit Gjeohapësinor “Për plotësimin e formatit 2 të PBA, 2019-2021, në përputhje me tavanet e miratuara në ligjin nr.99/2018 “Për buxhetin e vitit 2019”, është kërkuar të dërgohen pranë Ministrisë Financave dhe Ekonomisë, formatin nr.2, të PBA-së, 2019-2021, për shpenzimet korente dhe kapitale, në përputhje me tavanet e miratuara me ligjin nr.99/2018 “Për buxhetin e vitit 2019”. Me shkresën e Autoritetit Shtetëror të Informacionit Gjeohapësinor, nr.24/1, datë 21.01.2019, drejtuar Ministrisë Financave dhe Ekonomisë, dërgohen të dhënat e PBA-së 2019 – 2021, si më poshtë:

PROGRAMI BUXHETORE AFATMESEM 2019-2021

Lekë.

Emërtimi Artikullit	Art.	Buxheti 2018	2019	2020	2021
Paga	600	44.000.000	41.520.000	41.520.000	41.520.000
Sigurime Shoqërore	601	7.900.000	6.805.000	6.805.000	6.805.000
Mallra dhe shërbime të tjera.	602	22.000.000	14.000.000	14.000.000	14.000.000
Transferta korente të huaja.	605	1.000.000	1.000.000	1.000.000	1.000.000
Transferta për buxh.familjar & individë.	606	0	0	0	0
Totali		74.900.000	63.325.000	63.325.000	63.325.000

Me shkresën e Ministrisë Financave dhe Ekonomisë, nr.19433/274, datë 19.03.2018, drejtuar ASIG, “Dërgohet detajimi i buxhetit të vitit 2018-2020, për shpenzimet kapitale”, si më poshtë:

SHPENZIMET KAPITALE 2018 - 2020

Lekë.

Emërtimi Artikullit	Art.	Kodi Projektit	2018	2019	2020
Ndërtim i pjesshëm i kornizës referuese gjeodezike.	231	M870302	31.000.000	55.000.000	50.000.000
Blerje pajisje zyre dhe elektronike.	231	M870018	2.500.000	0	5.800.000
Projektim GIS Kombëtar.	231	M870251	4.500.000	0	0
Ndërtim GIS Kombëtar.	231	M870303	0	40.000.000	30.000.000
Shtim kapacitete të Infra.IT, për fotot ajrore.	231	M870304	0	0	15.000.000
Sofëare Inxhinierik GIS&hartografi.	230	M870250	5.000.000	8.000.000	8.000.000
Kosto lokale, për projektin, informacion gjeohapësinor, për një zhvillim të qëndrueshëm të tokës në zonën Tiranë-Durrës.	231	M870305	7.000.000	0	0
TVSH, për projektin, informacion gjeohapësinor, për një zhvillim të qëndrueshëm të tokës në zonën Tiranë-Durrës.	231	M870306	3.000.000	0	0
TVSH, për projektin, për rritjen e kapacitetit të ASIG për të siguruar informacionin gjeografik për përdoruesit.	231	M870307	4.000.000	4.200.000	1.300.000
Informacion Gjeohapësinor, për një zhvillim të qëndrueshëm të tokës në zonën Tiranë-Durrës.	231	M87007	50.000.000	0	0
Shuma			107.000.000	107.200.000	110.100.000

Përfundimishtë theksojmë se:

↓ Kërkesat për fonde buxhetore janë bërë në përputhje me ligjin organik të buxhetit, dhe sipas pasqyrave standart të përcaktuara në udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, për hartimin dhe përgatitjen e buxhetit të shtetit të ndarë në nivel titulli, kapitulli e artikulli dhe sipas natyrës së buxhetit

↓ Janë respektuar afatet e hartimit të programit buxhetor afatmesëm, nga ana e Autoritetit Shtetërorë të Informacionit Gjeohapësinor, Tiranë, konformë dispozitave ligjore përkatëse.

↓ Miratimi i fondeve buxhetore, për vitin 2017, 2018 dhe 2019. Referuar Ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe Udhëzimit nr.2, datë 06.02.2012 “Për procedurat Standarte të zbatimit të Buxhetit”, Udhëzimit nr. 9, datë 20.07.2018 “Për procedurat Standarte të zbatimit të Buxhetit”, Ligjeve

“Për Buxhetin e Vitit 2017, 2018 dhe 2019”, janë miratuar fondet Buxhetor për Autoritetin Shtetëror të Informacionit Gjeohapësinor Tiranë.

✓ Bazuar në nenin 43 “Detajimi i fondeve buxhetore” të Ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, në zbatim të pikës 8, të Udhëzimit nr.2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarte të zbatimit të Buxhetit”, Udhëzimit nr. 9, datë 20.07.2018 “Për procedurat Standarte të zbatimit të Buxhetit”, Udhëzimeve Plotësuese “Për zbatimin e Buxhetit të vitit, 2017, 2018 dhe 2019”, ka bërë detajimin e fondeve sipas klasifikimit buxhetor dhe brenda limiteve të miratuara.

✓ Detajimi i fondeve është bazuar në shkresat respektive për vitin 2017, 2018 dhe 2019, të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Për detajimin e Buxhetit të vitit 2017, 2018 dhe 2019”.

✓ Janë pasqyruar dhe rakorduar të gjitha ndryshimet e bëra dhe realizimi i Fondeve Buxhetore sipas klasifikimit buxhetor.

✓ Nga Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, është mbajtur Aktrakordimi me Degën e Thesarit, për planin fillestar, ndryshimet dhe planin përfundimtar të buxhetit për vitin 2017, 2018 dhe 2019.

✓ Në zbatim të zbatimit të pikës 58, të Udhëzimit të Ministrisë Financave nr.2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, Udhëzimit nr. 9, datë 20.07.2018 “Për procedurat Standarte të zbatimit të Buxhetit”, është dërguar detajimi i Buxhetit në Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë.

✓ Çdo kërkesë për fonde shtesë ose rishpërndarje është kryer konform pikës 74, të Udhëzimit të Ministrisë Financave nr.2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”. Udhëzimit nr. 9, datë 20.07.2018 “Për procedurat Standarte të zbatimit të Buxhetit”.

✓ Numri i punonjësve është përcaktuar konform pikës 83, të Udhëzimit të Ministrisë Financave nr.2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit” dhe Udhëzimit nr. 9, datë 20.07.2018 “Për procedurat Standarte të zbatimit të Buxhetit”, dhe Udhëzimit Plotësues “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2017, 2018 dhe 2019”.

✓ Janë hartuar dhe dërguar rregullisht në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, raportet e monitorimit të Buxhetit, për vitin 2017, 2018 dhe 8-mujorin e vitit 2019, të shoqëruar me relacion shpjegues.

✓ Raportimet tek nëpunësi autorizues, janë të shoqëruara me një relacion sqarues, sipas klasifikimit Buxhetor, për Titull, kapitull dhe Artikull, për shpenzimet korente dhe shpenzimet kapitale (Investimet).

✓ Lëvizja e fondeve buxhetore (shtesa e pakësime), miratuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, janë kryer konformë Udhëzimit të Ministrisë Financave nr.2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarte të zbatimit të Buxhetit” dhe Udhëzimit nr. 9, datë 20.07.2018 “Për procedurat Standarte të zbatimit të Buxhetit”.

Vlerësim Sistemi. Për periudhën objekt auditimi, përdorimi i fondeve buxhetore është kryer brenda kuotave të miratuara nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Në drejtim të raportimit të evidencave të realizimit të fondeve buxhetore, (Shpenzimet Korente dhe kapitale), evidentohet se janë rakorduar periodikisht me Degën e Thesarit, Tiranë dhe janë pasqyruar saktë të gjitha vlerat e fondeve buxhetore të çelura dhe përdorura për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, si dhe ndryshimet e bëra gjatë periudhave, të miratuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë me shkresa të veçanta.

Konkluzioni: Autoriteti Shtetëror i Informacionit Gjeohapësinorë, Tiranë, për vitin 2017, 2018 dhe 2019 për përdorimin e fondeve ka mbajtur marrëdhënie të vazhdueshme me Degën e Thesarit, Tiranë dhe ka ngritur sistemin e ndjekjes periodike dhe të rakordimit në vazhdimësi me degën e thesarit për përdorimin e fondeve buxhetore. Për periudhën objekte auditimi, vlerësohet se Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetësi, për planifikimin e buxhetit, miratimin dhe për përdorimin e fondeve buxhetore ka respektuar udhëzimet e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Është krijuar një sistem i plotë dhe ka funksionuar rregullisht, sistemi i planifikimit, ndjekjes periodike dhe progresive të realizimit, rakordimit dhe raportimit të fondeve buxhetore të përdorura nga Autoriteti Shtetëror i Informacionit Gjeohapësinor, Tiranë, për vitin 2017, 2018, dhe 2019.

Referuar Ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe Udhëzimit nr.2, datë 06.02.2012 dhe Udhëzimit nr. 9, datë 20.07.2018 “Për procedurat Standarte të zbatimit të Buxhetit”, “Për procedurat Standarte të zbatimit të Buxhetit”, Udhëzimit të Ministrisë Financave nr.7, datë 28.02.2014 Për përgatitjen e Projekt Buxheteve”, ka përgatitur dhe dorëzuar, Projekt Buxhetiet afatmesëm për PBA 2018-2020 dhe 2019-2021. Dorëzimi i kërkesave buxhetore është bërë brenda afatit ligjor. Planifikimi dhe miratimi i buxhetit është bërë i detajuar për çdo zë, brenda tavaneve të miratuara.

b) Vlerësimi i efektivitetit të shpenzimeve, argumentimi, dokumentimi dhe kontrolli i tyre.

Referuar Ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Udhëzimit nr.2, datë 06.02.2012 “Për procedurat Standarte të zbatimit të Buxhetit” dhe Udhëzimit nr.9, datë 20.07.2018 “Për procedurat Standarte të zbatimit të Buxhetit”, Ligjit “Për Buxhetin e Vitit 2017, 2018 dhe 2019”, për Autoritetin Shtetëror të Informacionit Gjeohapësinor, Tiranë, buxheti i miratuar dhe i alokuar për vitin 2017, 2018 dhe 2019 paraqitet sa më poshtë:

REALIZIMI I SHPENZIMEVE KORENTE, VITI 2017

Në lekë

Titulli	Kapitulli	Artikulli	Plani	Fakti	Diferenca	% e realizimit
01140	01	600	44.000.000	34.167.036	-9.832.964	78
01140	01	601	7.900.000	5.574.986	-2.325.014	71
01140	01	602	23.000.000	10.655.575	-12.344.425	46
01140	01	605	1.000.000	921.908	-78.092	92
Shuma			75.900.000	51.319.505	-24.580.495	68

Shpenzimet Korente për periudhën viti 2017, janë realizuar në shumën 51.319.505 lekë, nga 75.900.000 lekë të planit vjetor pra më pakë nga plani përfundimtar për 24.580.495 lekë, ose në masën 68 %, sipas artikujve rezulton si më poshtë:

Artikulli 600 “Paga personeli”, janë realizuar në shumën 34.167.036 lekë, nga 44.000.000 lekë, të planit vjetor, pra më pakë nga plani për 9.832.964 lekë ose në masën 78 %.

Artikulli 601 “Sigurime Shoqërore e Shëndetsore”, janë realizuar në shumën 5.574.986 lekë, nga 7.900.000 lekë, të planit vjetor, më pakë nga plani për 2.325.014 lekë ose në masën 71 %.

Artikulli 602 “Mallra e Shërbime”, janë realizuar në shumën 10.655.575 lekë, nga 23.000.000 lekë, të planit vjetor, pra më pakë nga plani për 12.344.425 lekë ose në masën 46 %.

Artikulli 605 “Transfera për organizmat ndërkombëtare (Kuotë anëtarësimi)”, janë realizuar në shumën 921.908 lekë, nga 1.000.000 lekë, të planit vjetor, ose në masën 92 %.

REALIZIMI I SHPENZIMEVE PER INVESTIME, VITI 2017

Në lekë

Titulli	Kapitulli	Artikulli	Plani	Fakti	Diferenca	% e realizimit
01140	01	230	74.000.000	0	-74.000.00	0
01140	01	231	108.150.000	7.745.616	- 100.404.384	7
Shuma			115.550.000	7.745.616	- 107.804.384	7

Shpenzimet Kapitale për vitin 2017, janë realizuar në shumën 7.745.616, lekë, nga 115.550.000 lekë, të planifikuara, me pakë për 107.804.384 lekë, ose në masën 7 %. Nga të cilat: Blerje Orendi 750.000 lekë, Blerje makineri profesionale 353.424 lekë dhe Blrje Drone, Ups, Sëitch, Hard disk, makineri printimi, grafimi etj, në shumën 6.642.192 lekë.

REALIZIMI I SHPENZIMEVE KORENTE, VITI 2018

Në lekë

Titulli	Kapitulli	Artikulli	Plani	Fakti	Diferenca	% e realizimit
01140	01	600	37.668.000	34.433.651	- 3.234.349	91
01140	01	601	5.732.000	5.629.944	- 102.056	98
01140	01	602	11.000.000	3.791.193	- 7.208.807	34
01140	01	605	1.000.000	822.556	- 177.444	82
Shuma			55.400.000	44.677.344	- 10.722.656	81

Shpenzimet Korente për periudhën viti 2018, janë realizuar në shumën 44.677.344 lekë, nga 55.400.000 lekë të planit vjetor pra më pakë nga plani përfundimtar për 10.722.656 lekë, ose në masën 81 %, sipas artikujve rezulton si më poshtë: Artikulli 600 “Paga personeli”, janë realizuar në shumën 34.433.651 lekë, nga 37.668.000 lekë, të planit vjetor, pra më pakë nga plani për 3.234.349 lekë ose në masën 91 %.

Artikulli 601 “Sigurime Shoqërore e Shëndetsore”, janë realizuar në shumën 5.629.944 lekë, nga 5.732.000 lekë, të planit vjetor, më pakë nga plani për 102.056 lekë ose në masën 98 %.

Artikulli 602 “Shpenzime Operative”, janë realizuar në shumën 3.791.193 lekë, nga 11.000.000 lekë, të planit vjetor, pra më pakë nga plani për 7.208.807 lekë ose në masën 34 %. Artikulli 605 “Transfera për organizmat ndërkombëtare (Kuotë anëtarësimi)”, janë realizuar në shumën 822.556 lekë, nga 1.000.000 lekë, të planit vjetor, ose në masën 82 %.

REALIZIMI I SHPENZIMEVE PER INVESTIME, VITI 2018

Në lekë

Titulli	Kapitulli	Artikulli	Plani	Fakti	Diferenca	% e realizimit
01140	01	230	0	0	0	0
01140	01	231	48.417.040	43.818.268	- 4.598.772	91
Shuma			48.417.040	43.818.268	- 4.598.772	91

Shpenzimet Kapitale për vitin 2018, janë realizuar në shumën 43.818.268, lekë, nga 48.417.040 lekë, të planifikuara, me pakë për 4.598.772 lekë, ose në masën 91 %. Nga të cilat: blerje pajisje elektronike për 2.532.390 lekë, blerje kasaforta për 396.000 lekë, ndërtim i kornizës referuese gjeodezike për 28.617.040 lekë dhe rimbursim TVSH-je, për 12.272.838 leke etj.

REALIZIMI I SHPENZIMEVE KORENTE, JANAR-GUSHT 2019

Në lekë

Titulli	Kapitulli	Artikulli	Plani	Fakti	Diferenca	% e realizimit
01140	01	600	41.520.000	22.571.485	- 18.948.515	55
01140	01	601	6.805.000	3.725.292	- 3.079.708	55
01140	01	602	15.164.000	3.926.372	- 11.237.628	26
01140	01	605	1.000.000	775.675	- 224.325	78
Shuma			64.489.000	30.998.824	- 33.490.176	48

Shpenzimet Korente për periudhën viti Janar-Gusht 2019, janë realizuar në shumën 30.998.824 lekë, nga 64.489.000 lekë të planit vjetor pra më pakë nga plani përfundimtar për 33.998.824 lekë, ose në masën 48 %, sipas artikujve rezulton si më poshtë:

Artikulli 600 "Paga personeli", janë realizuar në shumën 22.571.485 lekë, nga 41.520.000 lekë, të planit vjetor, pra më pakë nga plani për 18.948.515 lekë ose në masën 55 %.

Artikulli 601 "Sigurime Shoqërore e Shëndetsore", janë realizuar në shumën 3.725.292 lekë, nga 6.805.000 lekë, të planit vjetor, më pakë nga plani për 3.079.708 lekë ose në masën 55 %.

Artikulli 602 "Shpenzime Operative", janë realizuar në shumën 3.926.372 lekë, nga 15.164.000 lekë, të planit vjetor, pra më pakë nga plani për 11.237.628 lekë ose në masën 26 %.

Artikulli 605 "Transfera për organizmat ndërkombëtare (Kuatë anëtarësimi)", janë realizuar në shumën 775.675 lekë, nga 1.000.000 lekë, të planit vjetor, ose në masën 78 %.

REALIZIMI I SHPENZIMEVE PER INVESTIME, JANAR-GUSHT 2019

Në lekë

Titulli	Kapitulli	Artikulli	Plani	Fakti	Diferenca	% e realizimit
01140	01	230	8.000.000	0	- 8.000.000	0
01140	01	231	79.200.000	1.812.597	- 77.387.403	2
Shuma			87.200.000	1.812.597	- 85.387.403	2

Shpenzimet Kapitale për periudhën Janar-Gusht 2018, janë realizuar në shumën 1.812.597, lekë, nga 87.200.000 lekë, të planifikuara, me pakë për 85.387.403 lekë, ose në masën 2 %. Nga të cilët rimbursim TVSH-je.

Nga auditimi i kryer rezultoi se: Nga ana e Drejtorisë Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, janë ndjekur dhe evidentuar për çdo muaj dhe periudha progresive realizimi i fondeve Buxhetore, janë kryer rakordimet për çdo muaj dhe në mënyrë periodike me Degën e Thesarit, Tiranë, për vitin 2017, 2018 dhe 8-mujori parë 2019.

Përfundimishtë arrijmë në konkluzionen se: Nga ana e Nëpunësit zbatues është raportuar rregullishtë tek Nëpunësi Autorizues, konform pikës 48, të Udhëzimit të Ministrisë Financave

“Për procedurat standarte të zbatimit të Buxhetit”. Për periudhën objekte auditimi, vlerësohet se Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse për planifikimin e buxhetit, miratimin dhe për përdorimin e fondeve buxhetore ka respektuar udhëzimet e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Është krijuar një sistem i plotë dhe ka funksionuar rregullisht, sistemi i planifikimit, ndjekjes periodike dhe progresive të realizimit, rakordimit dhe raportimit të fondeve buxhetore të përdorura nga Autoriteti Shtetëror i Informacionit Gjeohapësinor, Tiranë, gjatë vitit 2017, 2018 dhe 8-mujori parë viti 2019.

Zbatimi i rregullave në fushën e pagave, sigurimeve dhe shpërblimeve, dokumentimi i pagave, llogaritja, rakordimi dhe kontabilizimi, viti 2017, 2018 dhe 8 mujori parë 2019.

Respektimi i dispozitave ligjore për pagat e punonjësve dhe realizimi i fondit të pagave. Sipas VKM nr.187, datë 08.03.2017, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendëskryeministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet e ministrive të linjës.....Institucionet në varësi të Këshillit të Ministrave/Kryeministrit, institucionet në varësi të ministrive të linjës.....”, pika 1/2 dhe Lidhja, bashkëlidhur kësaj VKM-je përcakton “Kategoritë e pagave të pozicioneve të punës për emërtesat “Specialist” deri në “Titullar Institucioni”, në institucionet qendrore të përcaktuara sipas pikës 1/2. Kriteri minimal i diplomës së shkollës së lartë për efekt të pranimit në pozicionin e punës:

Në këtë VKM përcakton qartë pagën për çdo kategori si dhe arsimin që duhet të ketë çdo punonjës i administratës publike për tu punësuar në një pozicion të caktuar pune, si dhe Urdhërin e Kryeministrit, të përmendur më lartë, **kategoria e pagave paraqitet si më poshtë:**

- ↓ Drejtori i Përgjithshëm, kategoria II-a.
- ↓ Drejtor Drejtorie, kategoria II-b.
- ↓ Përgjegjës Sektori, kategoria III-a/1.
- ↓ Specialistë, kategoria IV-a.

Nga auditimi me zgjedhje i listëpagesave, për periudhën objekt auditimi, Tetor-Dhjetor 2017, Prill-Qershor 2018, Tetor-Dhjetor 2018 dhe Janar-Mars 2019 rezultoi sa vijon:

Nivelet e pagave të punonjësve të ASIG (nëpunësve) janë zbatuar konformë:

✓ VKM nr.187, datë 08.03.2017, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendëskryeministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet e ministrive të linjës.....Institucionet në varësi të Këshillit të Ministrave/Kryeministrit, institucionet në varësi të ministrive të linjës.....”. Nga auditimi i kryer mbi zbatimin e kategorive të pagave të nëpunësve të ASIG, në përputhje me strukturën e mësipërme të miratuar, rezultoi se: Në mbështetje dhe në zbatim të akteve të mësipërme, ASIG, ka bërë miratimin e strukturës së saj, me emërtesat e punonjësve. Pra dokumentohet hartimi dhe miratimi i strukturës, me emërtesat e punonjësve, sipas kategorizimeve dhe klasifikimit të vendeve të punës dhe kategorive përkatëse të pagave të tyre, konformë akteve në fuqi, duke bërë të mundur zbatimin e Vendimeve të mësipërme. Nga verifikimi i kryer mbi respektimin e numrit të punonjësve rezultoi se ai sipas viteve paraqitet sa vijon:

Nr	Periudha	Numri i miratuar i punonjësve ne strukture	Fakti
1	Viti 2017	49	40
2	Viti 2018	46	42
3	Viti 2019	46	42

Përfundimisht sa sipër konkludojmë që:

- Ekziston një bashkëpunim i mirëvendosur për shkëmbimin e informacionit midis Drejtorive dhe Drejtorisë Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse;
- Gjurmët e auditimit, përfshijnë mbajtjen e dokumentacionit bashkëlidhur Listë Pagesave gjatë procesit të përlogaritjes së vlerës së pagës së grupit të nëpunësit.

Respektimi i dispozitave ligjore për llogaritjen dhe derdhjen e kontributit të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, tatimi mbi të ardhurat.

REALIZIMI I FONDIT TE PAGAVE

Nr	Periudha	Plan (vjetor)	Fakt	Realizimi (%)
1	Viti 2017	44.000.000	31.246.081	71
2	Viti 2018	37.668.000	34.443.651	91
3	Viti 2019 (8-mujori)	41.520.000	22.571.485	55

REALIZIMI I SIGURIMEVE SHOQERORE E SHENDETSORE

Nr	Periudha	Plan	Fakt	Realizimi (%)
1	Viti 2017	7.900.000	5.097.183	65
2	Viti 2018	5.732.000	5.629.944	98
3	Viti 2019 (8-mujori)	6.805.000	3.725.292	55

Ndaj Listë Pagesave janë bërë:

a.Ndalesat e kontributeve të detyrueshme për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore (pjesa e të punësuarit).

b.Ndalesat e tatimit mbi të ardhurat.Respektivisht, sipas periudhave:

Sigurimet shoqërore janë llogaritur dhe mbajtur konformë:

✓ Ligjit nr.7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe akteve nënligjore përkatëse.

Tatimi mbi të ardhurat personale nga punësimi janë llogaritur dhe mbajtur konformë:

✓ Ligjit nr.8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar dhe akteve nënligjore përkatëse.

✓ ASIG, ka llogaritur dhe derdhur në kohë të gjitha detyrimet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore dhe tatimin mbi të ardhurat nga punësimi që rrjedhin nga pagat e personelit.

Respektimi i dispozitave ligjore për krijimin e fondit të vecantë, dhënien e shpërblimeve të ndryshme. (për rezultate të mira në punë, ndihma për fatkeqësi, nevoja kulturore etj.).

Për periudhën objekt auditimi, nuk ka krijim dhe përdorim të fondit të vecantë, dhe dhënia shpërblimesh të ndryshme, për rezultate të mira në punë, ndihma e fatkeqësi etj.

Dokumentimi i punës dhe i pagës.

Nga auditimi i Listë Pagesave u evidentua dhe konstatua që :

✓ Listë pagesat janë të plotësuara me të gjitha të dhënat sipas VKM-së së pagave (Paga e kategorisë, paga e grupit vjetërsia për vite pune, si dhe shtesat e tjera të përfituara nga pozicioni i punës).

✓ Listë pagesat janë plotësuar nga punonjësi i caktuar për hartimin e pagave. Ato janë nënshkruar nga punonjësi i caktuar për menaxhimin e burimeve njerëzore, nëpunësi zbatues (Drejtori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse) dhe Titullari i Institucionit/Nëpunësi Autorizues i njësisë si përgjegjës për financat e njësisë, konformë kërkesave të përcaktuara në

pikën 69, të Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

✓ Përmbledhja e listë pagesave që shoqëron Urdhërin për Shpenzimin e pagave është nënshkruar nga Nëpunësi Zbatues (Drejtori i Financës) dhe Nëpunësi Autorizues (Drejtori i Përgjithshëm).

✓ Të gjitha detyrimet e ASIG, për pagesën e pagave të punonjësve janë paguar vetëm nga llogaria e thesarit, nëpërmjet sistemit të thesarit nga personat e autorizuar.

✓ ASIG, ka llogaritur dhe derdhur në kohë të gjitha detyrimet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore dhe tatimin mbi të ardhurat nga punësimi që rrjedhin nga pagat e personelit.

Përfundimisht sa sipër, nga auditimi i sistemit të pagave dhe pagesave të kryera pranë organeve Tatimore, për derdhjen e kontributit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat, auditimi vlerëson dhe konkludon se;

➤ Kontrolli i brendshëm në këtë sistem ka funksionuar i plotë nga të gjitha hallkat brenda Institucionit.

➤ Ekzistenca dhe funksionimi i sistemit të kontrollit të brendshëm ka sjellë për pasojë; -që risku në këtë sistem të vlerësohet, monitorohet dhe minimizohet (vetëkorrigjimet e kryera nga Sektori i Financës, lidhur me përcaktimin dhe përlllogaritjen e pagës së grupit.)

- parandalimin dhe zbulimin e gabimeve, parregullsive, shkeljeve ligjore dhe përcaktimin e masave për korigjimin e tyre;

➤ Menaxhimi ka marrë masa për identifikimin dhe reduktimin e riskut, me masat e duhura të kontrollit,

Risku paraqitet në Nivel të ulët.

Shpenzime për Telefoni celulare. Për periudhën e audituar, (01.01.2017 -31.08.2019), rezulton se: janë kryer shpenzime për kryer shpenzime për telefoninë celulare, në shumën 258.846 lekë, konformë VKM nr. 864 datë 23.07.2010 “Për pajisjen me numër telefoni celular të personave juridikë, publik”. Shpenzimet në nivel vjetor për këtë llojë shërbimi, janë jo më shumë se 2 përqintë e totalit të shpenzimeve për mallra dhe shërbime, të miratuar në buxhetin vjetor. Janë respektuar tarifat e përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore.

Mbi shpenzimet e kryera për udhëtime e dieta brenda vendit. Për periudhën 01.01.2017 deri më 31.08.2019, rezulton se: Në zbatim të VKM-s nr.997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda Vendi”, i ndryshuar, Autoritetit Shtetëror i Informacionit Gjeohapësinore, Tiranë, ka kryer shpenzime Udhëtimi e dieta brenda vendit, për shumën 1.091.000 lekë. Nga auditimi i kryer rezuloi se: janë zbatuar kërkesat e VKM-së, 997, datë 10.12.2010, “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda Vendi”, ndryshuar.

Mbi shpenzimet e kryera për Udhëtime jashtë vendit. Për periudhën 01.01.2017 deri më 31.08.2019, rezulton se: Në zbatim të VKM nr. 870, datë 14.12.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit” dhe Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 22, datë 10.07.2013 “Mbi zbatimin e VKM, nr. 870, datë 14.12.2011”, Autoritetit Shtetëror i Informacionit Gjeohapësinore, Tiranë, ka kryer shpenzime Udhëtimi e dieta jashtë vendit, për shumën 2.402 Euro.

c) Zbatimi i procedurave të prokurimeve publike përfshirë dhe blerjet me vlera të vogla.

Për periudhën objekt auditimi, viti 2017, 2018 dhe 8 mujori i vitit 2019, Autoriteti Kontraktor në zbatim të plotë të kërkesave të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM, nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, dhe Udhëzimit për blerjet me vlera të vogla, ka:

- planifikuar në fillim të vitit natyrën, sasitë dhe llojet e kontratave, që do të prokurohen sipas formave të ndryshme të prokurimit, (blerje me vlera të vogla).

- hartuar rregjistrin e parashikimeve të prokurimit publik.

- hartuar rregjistrin e realizimit të prokurimit publik.

Për periudhën objekt auditimi, në fillim të çdo vitimi është ngritur Komisioni i Prokurimit me Vlera të Vogla, konformë: Udhëzimit të Agjencisë Prokurimit Publik, nr.3, datë 27.01.2015 “Për Proçedurën e Prokurimit me Vlerë të Vogël”, i ndryshuar, dhe Udhëzimin nr.3, datë 08.01.2018 “Mbi përdorimin e proçedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, i ndryshuar, e konkretisht me Urdhërat nr.6, datë 12.01.2017; Urdhërin nr.8, datë 14.01.2018 dhe Urdhërin nr.7, datë 14.01.2019.

Për vitin 2017: Me shkresën e ASIG, nr.21, datë 11.01.2018 “Dergohet Rregjistri i realizimit të Prokurimeve Publike për vitin 2017”, është dërguar rregjisrti i realizimit të prokurimeve publike. Në artikullin 602 “Mallra e shërbime”, janë parashikuar 20 proçedura prokurimi, me vleftë 12.765.000 lekë pa TVSH, nga të cilat një proçedure prokurimi “Kërkesë për propozim”, me vleftë 3.600.000 lekë (Roje objektesh). Jane realizuar 12 proçedura prokurimi me vleftë 5.689.119 lekë me TVSH, nga të cilat, një proçedurë “Kërkesë për propozime”, në shumën, 3.325.299 lekë. Në artikullin 231, “Investime”, janë parashikuar 9 proçedura prokurimi me vleftë 96.258.333 lekë pa TVSH, nga të cilat: 4 proçedura Blerje me vlere të vogël, për shumën 1.800.000 lekë pa TVSH, 1, proçedurë e hapur me vlerë 69.166.667 lekë (Anulluar), 2 proçedura të përqëndruara (Ministria e Brendëshme), për shumën 16.124.999 lekë pa TVSH, 2 proçedura “Kërkesë për propozime”, për shumën 6.166.667 lekë.(1 proçedure pezulluar nga AKSHI). Janë realizuar 6 proçedura për shumën 7.745.636 lekë me TVSH, nga të cilat: 4 proçedura Blerje me vlere të vogël, për shumën 1.571.424 lekë me TVSH, 2 proçedura të përqëndruara (Ministria e Brendëshme), për shumën 6.174.192 lekë me TVSH.

Për vitin 2018: Me shkresën e ASIG, nr.09, datë 10.01.2019 “Dergohet Rregjistri i realizimit të Prokurimeve Publike për vitin 2018”, është dërguar rregjisrti i realizimit të prokurimeve publike. Janë parashikuar 18 proçedura prokurimi me fond limit 28.437.860 lekë pa TVSH, jane realizuar 18 proçedura me vleftë kontrate 27.950.538 lekë, nga cilat 1 proçedura e hapur, për shumën 25.514.200 lekë.

Për periudhën 01.01.2019 – 31.08.2019: Me shkresën e ASIG, nr.190/1, datë 09.09.2019 “Dergohet Rregjistri i Realizimit të Prokurimeve Publike Janar-Gusht 2018”, është dërguar rregjisrti i realizimit të prokurimeve publike. Pë periudhë Janr – Gusht 2019, janë zhvilluar 11 proçedura prokurimi me fond limit 1.454.818 lekë dhe vleftë kontrate 1.260.761 lekë.

Përfundimishtë arrijmë në konkluzionin: Proçedurat e Prokurimit me vlera të vogla janë kryer, konformë Udhëzimit të Agjencisë Prokurimit Publik nr.3, datë 27.01.2015, ndryshuar me Udhëzimin nr.1, datë 21.04.2016 dhe Udhëzimin nr.3, datë 08.01.2018 “Mbi përdorimin e proçedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, i ndryshuar.

Për periudhën objekt auditimi, konformë, pikes 42, të Udhëzimit të Ministrisë Financave nr.30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, i ndryshuar, është ngritur, është ngritur Komisioni i marrjes në dorëzim,

d) Zbatimi i rregullave për kontabilizimin dhe raportimin financiar.

Përdorimi i automjeteve, harxhimi i karburantit.

Me Urdhërin e Përbashkët, Kryeministria nr.6718, datë 18.11.2016 dhe ASIG nr.394, datë 18.11.2016 “Për kalim kapital”, është kryer kalimi kapital, pa pagesë, i dy automjeteve nga

Kryeministria tek ASIG, në mbështetje të pikës 4, nenit 102 të Kushtetutës, të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, dhe të shkronjes “b”, të pikës 2, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.153, datë 03.04.1993 “Për kalimin e objekteve të mjeteve kryesore të ndërmarrjeve dhe institucioneve shtetërore”, **është urdhëruar kalimi kapital pa pagesë të 2 (dy) automjeteve nga Kryeministria tek ASIG.**

Me procesverbalin, datë 18.11.2016, në Kryeministri, është mbajtur procesverbali i dorëzimit të automjetit tip “TOYOTA RAY 4”, me numër shasie: JMTZPREV30D019811, nga Kryeministria në ASIG, bashkalidhur dhe Inventarin: 1.Goma, 4 copë + 1 copë rezervë. 2.Krik 1 copë. 3.Xhiromakine 1 copë, 4.Radiomegnetofon 1 copë, 5.Shtroje 1 palë, 6.Celës Kuadri 2 copë, 7.Bateri 1 copë. **Kilometrazhi, ka përshkruar 15 Kilometër.** Normativa e harxhimit të karburantit **4.3 litra/100 km.**

Me procesverbalin, datë 18.11.2016, në Kryeministri, është mbajtur procesverbali i dorëzimit të automjetit tip “TOYOTA RAY 4”, me numër shasie: JMTZPREV10D018642, nga Kryeministria në ASIG, bashkalidhur dhe Inventarin: 1.Goma, 4 copë + 1 copë rezervë. 2.Krik 1 copë. 3.Xhiromakine 1 copë, 4.Radiomegnetofon 1 copë, 5.Shtroje 1 palë, 6.Celës Kuadri 2 copë, 7.Bateri 1 copë. **Kilometrazhi, ka përshkruar 15 Kilometër.** Normativa e harxhimit të karburantit **4.3 litra/100 km.**

Me shkresën nr.414, datë 09.12.2016 “MEMO”, hartuar nga Drejtori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm të ASIG; Mbi përcaktimin e rregullave të përdorimit të normës së konsumit të automjeteve në administrim të ASIG. Theksohet:a) Eshtë e nevojshme përcaktimi i rregullave të qartë mbi mënyrën e përdorimit dhe administrimit të automjeteve nga punonjësit e ASIG; b) Përcaktimi i normës së konsumit të tyre nëse nga përdorimi i makinave brenda dhe jashtë Bashkisë Tiranë do të ketë diferenca midis faktit dhe dokumentacionit shoqëruar që përcakton normën e konsumit për këto automjete.**Eshtë domosdoshme:**

1.Të përgatisim një projekt-urdhër, për përcaktimin e rregullave dhe formularëve të nevojshëm për evidentimin e saktë të kilometrave të përshkruara dhe harxhimin mujor të karburanit.

2.Të krijojmë një komision të posacëm për përcaktimin e normës së konsumit si në zonat urbane ashtu dhe në ato interurbane nëpërmjet matjes reale të saj do të jetë e nevojshme, në zbatim të pikës 2, si më lartë.

Me shkresën nr.420, datë 12.12.2016 “Urdhër nr.90, datë 12.12.2016”, “Për përdorimin dhe mirëmbajtjen e automjeteve në pronësi të autoritetit shtetëror për informacionin gjeohapësinor – ASIG”, është hartuar urdhëri për përdorimin e automjeteve të Autoritetit Shtetëror të Informacionit Gjeohapësinor. Referuar pikës 8, të këtij urdhëri.....normativa e konsumit për efekt shkarkimi të karburantit të jetë 5.5 litra/100 km, për lëvizje në zona urbane dhe 4.3 litra/100 km në zona interurbane.

Me shkresën nr.7, datë 06.01.2017 “MEMO”, hartuar nga Drejtori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm të ASIG; Mbi përcaktimin e normës së konsumit të karburantit për automjetet në administrim të ASIG, thekson: Gjatë muajit dhjetor janë përshkruar 944 km, nga automjeti **AA 458 PI**, janë tërhequr dhe furnizuar mjeti 100 litra naftë. Sipas normës së konsumit të përcaktuar nga COC-në e mjetit, justifikohet si konsum për Km e përshkruar më lartë, gjithsej **43 litra**. Diferenca që duhet të jetë në serbatorin e automjetit është 57 litra, nga verifikimi i gjendjes rezulton një sasi më e vogël se 57 litra. Gjatë muajit dhjetor janë përshkruar 1929 km, nga automjeti **AA 459 PI**, janë tërhequr dhe furnizuar mjeti 150 litra naftë. Sipas normës së konsumit të përcaktuar nga COC-në e mjetit, justifikohet si konsum për Km e përshkruar më lartë, gjithsej 84 litra. Diferenca që duhet të

jetë në serbatorin e automjetit është 66 litra, nga verifikimi i gjendjes rezulton një sasi më e vogël se 66 litra. Është propozuar krijimi i një komisioni të posaçëm për verifikimin faktik të normës së konsumit.

Me shkresën nr.7/1, datë 09.01.2017 “Urdhër nr.5, datë 09.01.2017”, “Për përcaktimin e normës konsumit të karburantit për automjetet në pronësi të ASIG. Është ngritur grupi i punës

Me shkresën nr.7/2, datë 20.01.2017 “Procesverbal”, hartuar nga grupi i punës i ngritur me urdhërin nr.5, datë 09.01.2017, për verifikimin faktik të normës së konsumit të karburantit. Është përcaktuar 8.1 litra/100 Km për lëvizje në zona urbane dhe 6.47 litra/100 Km, për lëvizje në zona interurbane.

Me shkresën nr.420/1, datë 21.01.2017 “Urdhër nr.90/1, datë 21.01.2017”, “Për ndryshimin e urdhërit nr.90, datë 12.12.2016” “Për përdorimin dhe mirëmbajtjen e automjeteve në pronësi të autoritetit shtetëror për informacionin gjeohapësinor – ASIG”, është hartuar urdhëri për përdorimin e automjeteve të Autoritetit Shtetëror të Informacionit Gjeohapësinor. Pika 8, ndryshohet sa vijon: “Konsumi i karburantit të llogaritet mbi bazën e kilometrave të përshkruara dhe normës së konsumit sipas rastit, lëvizje në zona urbane apo interurbane. Norma e konsumit për efekt të shkarkimit të karburantit të jetë 8.1 litra/100 Km, për lëvizje në zona urbane dhe 6.47 litra/100 Km, për lëvizje në zona interurbane.

Konsumi i Karburantit sipas llojit për periudhën 01.01.2017 – 30.08.2019.

Nr	PERIUDHA	AA 458 PI		AA 459 PI	
		Naftë/litra	KM/Përshkruara	Naftë/litra	KM/Përshkruara
1	Viti 2017	547	7586	638	10245
2	Viti 2018	1615	23930	1156	17168
3	01.01-30.08.2019	465	6933	544	8058
	Shuma	2627	38449	2338	35471

Inventarizimi i aktiveve: Për periudhën e objekt auditimi, për evidentimin e aktiveve si dhe për administrimin dhe qarkullimin e tyre, Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, ka mbajtur kartelat të artikujve të inventarit, dokumentacionin fletë-dalje e fletë-hyrje të magazinës si dhe librat e kontabilitetit për evidentimin e lëvizjeve të aseteve, konformë kërkesave të Ligjit nr.9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, të ndryshuar si dhe të Udhëzimit të Ministrisë Financave nr.30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”.

Rregjistrimi i aktiveve është kryer konformë Kreut III, “Rregjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”, të Udhëzimit të Ministrisë Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”. Hyrja e aktiveve për çdo rastë dokumentohet me fletë hyrjen përkatëse, të hartuat sipas gjendjes fizike të tyre, konformë pikës 37, të Udhëzimit të Ministrisë Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”. Dalja e aktiveve për çdo rastë, janë kryer konformë pikës 38, të Udhëzimit të Ministrisë Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”. Dokumentimi i lëvizjes së aktiveve është kryer konform pikës 35, të Udhëzimit të Ministrisë Financave nr.30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”. Marrja në dorëzim e aktiveve, është bërë konformë pikës 42, 43, 44, të Udhëzimit të Ministrisë Financave nr.30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”. Në çdo rastë nga ana e nëpunësit zbatues, janë kryer kontrole paraprake (kontrole të rregullshmërisë së jashtëme, nga pikëpamje e zbatimit të ligjëshmërisë, saktësisë veprimeve aritmetike, numrin rendore të

dokumentit, adresës, dokumentat justifikuese etj), konformë pikës, 52-60, të Udhëzimit të Ministrisë Financave nr.30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”.

Për vitin 2017 dhe 2018, me Urdhërin e Drejtorit Përgjithshëm të ASIG, “Për ngritjen e komisionit të Inventarizimit të Aktiveve të Qëndrueshme dhe Qarkulluese”, është ngritur **Komisioni i Inventarizimit të Aktiveve**, konformë pikës 81 e 82 “Përgjegjësitë për Inventarizimin”, të Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, sipas viteve. Nga kryerja e Inventarizimit të Aktiveve të ASIG, nga ana e Komisionit të Inventarizimit, janë konstatuar aktive që janë jashtë përdorimit, të cilat nuk kanë vlerë përdorimi, dhe janë nxjerrë nga përdorimi.

Përfundimishtë arrijmë në konkluzionen se: Komisionet e Inventarizimit për periudhën objekt auditimi, janë krijuar çdo vit, konformë me pikën 82, “Përgjegjësitë për inventarizimin”, Kreu IV “Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve”, të Udhëzimit të Ministrisë Financave nr.30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”. Për inventarizimin e vlerave materiale, fletët e inventarizimit janë të plotësuar rregullisht për gjendjen fizike për çdo emërtim inventari të aseteve, dokumentacioni rezultojnë të firmosura nga të gjithë antarët e komisionit dhe punonjësit përgjegjës material. Janë evidentuar inventari në përdorim për çdo punonjës të institucionit, si dhe inventari në magazinën e Autoritetit Shtetëror të Informacionit Gjeohapësinor. Për periudhë objekt auditimi janë konstatuar asete jashtë përdorimit, janë bërë veprimet e nxjerrjes jashtë përdorimit.

Auditimi vlerëson se në Autoritetin Shtetëror të Informacionit Gjeohapësinor, Tiranë, për periudhën objekt auditimi është krijuar dhe ka funksionuar sistemi i evidentimit dhe verifikimit të gjendjes nëpërmjet inventarizimit fizik të aseteve pasuri të ASIG (për vitin 2017, 2018).

Përgatitja e pasqyrave Financiare. Pasqyrat Financiare për vitin 2017 dhe 2018 janë hartuar e dorëzuar në Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, brenda afateve të përcaktuara. U krye verifikimi formal i plotësimit të pasqyrave financiare. Për këtë u krahasuan të dhënat e hedhura në postet e bilancit me të dhënat e ditarëve. Opinioni është mbështetur në të dhënat e kontabilitetit, në inventaret fizik e kontabël të kryer, në informacionet dhe shpjegimet e dhëna nga stafi i Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit. Mbi bazën e auditimit të kryer sipas normave profesionale, Grup i Auditimit shpreh opinionin se llogaria vjetore e Autoritetit Shtetëror të Informacionit Gjeohapësinor, Tiranë, ka besueshmërinë për t'u konsideruar të rregullta. **Kjo për arsye se:**

Plotësimi i pasqyrave financiare rezulton të jenë në përputhje me dispozitat ligjore për rregullat kontabile. Postet e llogarive janë plotësuar drejtë dhe saktë, në përputhje me standardet e kontabilitetit, nga ku rezultoi se: Kontabilitetit, është hartuar sipas kërkesave të udhëzimit përkatës “Për mbyllje e llogarive vjetore në Institucionet Buxhetopre”, pasi:

- Në relacion janë dhënë shpjegimet e nevojshme për plotësimin e pasqyrave financiare.
- Ndryshimet e aktiveve të qëndrueshme të patrupëzuara e të trupëzuara në krahasim me periudhën e ushtrimit paraardhës, janë përshkruar në relacion me shifra e komente konkrete, sipas objekteve të blera apo veprimeve të kryera me këto.
- Në grupin e klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” është evidentuar **3.697.240 lekë** që përfaqëson operacione me shtetin në shumën **3.697.240 lekë** shumë e cila është e analizuar në mënyrë analitike.

➤ Shuma e evidentuar në këtë post është e njëjtë me shumën sipas rakordimeve me thesarin.

➤ Sipas llogarisë 4342 *“Të tjera operacione me shtetin kreditor”* paraqitet në bilanc **3.697.240 lekë**, shumë e cila është e analizuar dhe që pasqyrojnë detyrimet afat shkurtëra të palikuidura me mbylljen e ushtrimit të vitit 2018, sic janë shpenzimet e personelit, detyrimet për tatimet dhe sigurimet shoqërore etj.

➤ Në grupin e llogarive 1050, 1051 që formojnë grande kapitale të brendshme shpjegohet se janë tranzituar nëpërmjet llogarisë 476 apo 520 *“disponibilitete në thesar”*, në përputhje me kërkesat e udhëzimit të sipërpërmendur. Gjendja e pasqyruar në aktivet qarkulluese në gjendjet e inventarit për shumën, është e njëjtë me të dhënat e inventarizimit fizik të kryer në fund të vitit. Dokumentet justifikuese për kryerjen e veprimeve ekonomike janë plotësuar konform dispozitave ligjore në fuqi. Gjithashtu janë zbatuar drejt parimet e përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit.

Përfundimishtë arrijmë në konkluzionin se: mbyllja e llogarisë vjetore është kryer në përputhje me kërkesat e Ligjit nr.9477, datë 9.2.2006 *“Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”* si dhe me VKM nr. 248, datë 10.04.1998 *“Për miratimin e planit kontabël publik të organeve të pushtetit lokal, institucioneve shtetërore qendrore e lokale, si dhe të njësive që varen prej tyre”*, ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001 *“Për disa ndryshime në VKM nr. 248, datë 10.04.1998 “Për miratimin e planit kontabël publik të organeve të pushtetit lokal, institucioneve shtetërore qendrore e lokale, si dhe të njësive që varen prej tyre”* dhe Udhëzimit të Ministrisë Financave nr.16, datë 27.12.2007 *“Për përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor”* dhe Udhëzimit të Ministrisë Financave nr.8, datë 09.03.2018 *“Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”*.

Grupi i auditimit, falenderon me këtë rast, subjektin e audituar për bashkëpunimin e treguar në realizimin e këtij auditimi.

Për grupin e auditimit

Latif ÇELA

Flori ALLA

FORMULARI I VLERËSIMIT

SUBJEKTI I AUDITUAR:

ASIG

Pas përfundimit të rishikimit të auditimit në subjektin tuaj, mirëpresim rekomandimet tuaja, për të na ndihmuar të vlerësojmë performancën tonë personale dhe për të identifikuar fushat ku përmirësimi në qasjen tonë do të ishte i dobishëm për ju dhe të tjerë.

<i>Shkalla e vlerësimit</i>					
1 - Shumë të kënaqur 2 – Të kënaqur 3 – Të pakënaqur 4 – Shumë të pakënaqur					
KOMPONENTËT E PERFORMANCËS	1	2	3	4	Komente
<p>PLANIFIKIMI I AUDITIMIT</p> <p>Sa të kënaqur jeni që :</p> <p>1. Ju janë dhënë mundësi të përshtatshme për të rënë dakord në fushë veprimin e auditimit para se të fillonte?</p> <p>2. Ju është dhënë njoftimi i duhur për kohën dhe kohëzgjatjen e auditimit?</p>					
<p>KRYERJA E AUDITIMIT</p> <p>Deri në çfarë mase jeni të kënaqur që:</p> <p>3. Audituesit e brendshëm kanë qenë profesionalë dhe të sjellshëm gjatë kryerjes të auditimit ?</p> <p>4. Audituesit e brendshëm kishin njohuri të mjaftueshme në fushën e veprimtarisë tuaj?</p> <p>5. A ju është komunikuar në mënyrën e duhur progresi i angazhim auditimit, duke përfshirë detajet e çështjeve kryesore që u shqyrtuan?</p>					
<p>RAPORTIMI I REZULTATEVE TË AUDITIMIT</p> <p>Sa të kënaqur jeni që:</p> <p>6. Projekt-raporti është marrë brenda një kohe të pranueshme të parashikuar ?</p> <p><i>Data e përfundimit të punës në terren: xx / xx / xx</i> <i>Data e lëshimit të projekt raportit: xx / xx / xx</i></p> <p>7. Projekt raporti është prezantuar në mënyrë të</p>					

<p>qartë në lidhje me formatin dhe qartësinë e gjuhës së përdorur?</p> <p>8. Pas përgjigjeve të menaxhimit për komentet , raporti përfundimtar është marrë brenda një kohe të pranueshme të parashikuar ?</p> <p><i>Data e marrjes se komenteve: xx / xx / xx</i></p> <p><i>Data e lëshimit te raportit final: xx / xx / xx</i></p> <p>9. Rekomandimet ofruan zgjidhje praktike dhe konstruktive për çështjet e identifikuar?</p> <p>10. Argumentimi për gjetjet dhe përfundimet e auditimit a janë shpjeguar në mënyrë të kënaqshme, komentet/ pikëpamjet tuaja a janë marrë parasysh ?</p>					
<p>CILËSIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM</p> <p>Sa të kënaqur jeni që:</p> <p>9. Zbatimi i rekomandimeve do të kontribuojë në përmirësimin e menaxhimit të risqeve ,të kontrollit dhe proceseve të qeverisjes?</p> <p>10. Auditimi ju ofroi informacionin që do t'ju ndihmojë për të përmbushur përgjegjësitë e raportimit tuaj të sigurimit të cilësisë ?</p> <p>11. Auditimi i brendshëm a kontribuon në përmirësimin organizativ për arritjen e objektivave strategjike në njësinë tuaj publike?</p>					
<p>SHËRBIME TË TJERA TË OFRUARA NGA AUDITIMI I BRENDSHËM</p> <p>12. A jeni të vetëdijshëm se njësia e auditimit të brendshëm ofron shërbime këshillimi?</p> <p>13. Nëse ju keni përdorur shërbimet e këshillimit të ofruara nga auditimi i brendshëm, a jeni të kënaqur me kontributin e dhënë?</p>					

Ps: Duke përdorur shkallën e vlerësimit si më poshtë, ju lutem rrethoni numrin në kolonën e djathtë që reflekton pikëpamjet tuaja në punën tonë në secilën nga fushat e përmendura. Në qoftë se jepet një vlerësim 3 ose 4, ju lutem jepni më shumë hollësi në seksionin "Komente" në mënyrë që ne të mund të marrim parasysh si mund të përmirësohemi.